



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

Master Profesional Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim”

ofruar nga

Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Erleta Çelmeta (Mato)

Prof.Asoc.Dr. Florinda Tarusha

Shtator / 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional
“Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim”.**

1	IAL aplikues:	Universiteti “ Barleti”.
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional “Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim”.
4	Urdhri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS nr.587,datë 04.10.2022
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 6 PAE/0 PAK 2023- 2024 6 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2022- 2023 3 studentë 2023- 2024 2 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadër të akreditimit të programit të ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim” në Institucionin e Arsimit të Lartë “Barleti”, me vendndodhje në Tiranë (UniBA), (në këtë raport, që tani dhe më tutje Universiteti “Barleti”, Tiranë, do të referohet si akronimi ‘UniBA), procesi i vlerësimit u zhvillua në përputhje me agjendën e miratuar bashkërisht të programit të studimit. Raporti pasues përfshin vëzhgimet dhe konkluzionet e nxjerra nga analiza e vlerësimit të jashtëm.

Programi mbulohet nga njësi bazë Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) që funksionon brenda njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS), krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 571, datë 12.08.2005, riorganizuar me Urdhër të Ministrit të MASR nr. 511, datë. 24.10.2019¹

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm i përket programit të studimit me kohë të plotë, të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim". Për programin e studimit, **Master Profesional Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim”**, të dhënat janë sa më poshtë vijon:

Programi Master Profesional në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” me Urdhër të MAS Nr. 5701/1 Prot., nr. 508, datë 06.09.2022 kërkon të akreditohet për herë të parë.

Programi i studimit është i regjistruar si program i ciklit të dytë Master Profesional, Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe përfshihet në fushën kryesore “Shkenca Sociale” ku fusha e studimit është kurrikula, didaktika dhe aftësimi praktikë në lëndët e gjuhës shqipe, letërsisë dhe të aftësive të komunikimit. Programi MPMGJK (Master Profesional në Mësuesi Gjuhë dhe Komunikim) ofrohet në gjuhën shqipe, në formë studimi me kohë të plotë, me kohë normale dy vite akademikë, është i ndarë në katër semestra dhe në përfundim, pasi studenti ka fituar 120 ECTS, pajiset me diplomë “Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim” (MPMGJK).

Programi i studimit MPMGJK është i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga VKM nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL dhe VKM nr. 185, dt. 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar”.

Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, i cili ka më shumë se një dekadë eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe trajnimit të stafit të mësuesve, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, njësi bazë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional mbulon

¹ [Vendim Senati, Nr.24, datë 17.10.2022, “Për miratim ndryshimi i organigramës së UniBa”]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Coob

fr

lëndët e fushës pedagogjike, ndërsa Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit mbulon kryesisht lëndët e fushës psikologjike. Njësia bazë administrative për ofrimin e programit është Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

PERMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë, të përcaktuara me VKM nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, për programin e studimit të ciklit të dytë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, FE, DP, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.Dr. Erleta Çelmeta (Mato) dhe Prof.Asoc.Dr. Florinda Tarusha. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Alma Arapi

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhër i MASH nr. 81, datë 25.02.2013
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017
- Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, ASCAL

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” Mësuesi “Gjuhë dhe Komunikim” (2023)² i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Statuti i UniBA, Rregullore e UniBA, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS), paketa e

plotë e dokumentacionit të programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion. Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 19 dhe 20 Mars 2024. Gjatë këtyre takimeve, u zhvilluan bashkëbisedime të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda me Drejtuesin e Njesisë Qendrore; bisedë me Dekanin e Fakultetit të të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS); bisedë me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bisedë me stafin akademik të programit të studimit; bisedë me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore, bisedë me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit; bisedë me përfaqësues të studentëve të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Mësuesi Gjuhë dhe Komunikim"; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë, si edhe bisedë me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:

- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit që mbulon programin e studimit
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program
- Takim me studentë të këtij programi
- Takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Njesisë së Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë së Studimeve Master
- Takim me koordinatoren e kërkimit shkencor në UniBa
- Takim me përfaqësues të Zyrës së ALUMNI dhe Karrierës dhe Zyrës së Shërbimeve Studentore
- Takim me grupin e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë
- Takim me Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore
- Takim në Sekretarinë mësimore
- Takim përfundimtar me Përgjegjësën e Departamentit

Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan biseda të qëllimta që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm.

Vëzhgimet në Institucion. Në të dy ditët e vizitës në Institucion u mundësuan vizitat në auditorët mësimorë, Bibliotekën, mjediset e shërbimeve të studentëve etj. Vlen të theksohet se përgjatë gjithë procesit të vizitës, Institucioni kishte marrë të gjitha masat dhe tregoi disponibilitet shumë të lartë dhe cilësor, si në organizim ashtu dhe në bashkëpunim, për realizimin me sukses të të

gjitha stadeve të procesit, si edhe duke ju përgjigjur në kohë kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Barleti”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 99 / 23 Prot, datë 11.09.2024. Universiteti “Barleti”, njofton në ASCAL më datë 17.09.2024, me anë të shkresës me Nr.1029 Prot, datë 16.09.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" është një program që stimulon përgatitjen e specialistëve të edukimit në funksion të interesave kombëtare për një cilësi më të mirë të arsimit të përgjithshëm gjuhësor në të gjitha nivelet e shkollimit. Nëpërmjet këtij programi studimi me 120 ECTS synohet të mbahen lidhje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme me tregun e punës përmes një bashkëpunimi të shumanshëmme institucione arsimore publike dhe jopublike, në funksion të tregut të punës, gjë që kërkohet të arrihet përmes praktikave profesionale të studentëve. ³
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Duke nxitur zhvillimin e kompetencave profesionale, ky program studimi bën të mundur konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore në sistemin arsimor shqiptar përmes pasurimit të traditës me koncepte dhe aftësi bashkëkohore. Departamenti i shkencave të edukimit dhe trajnimit profesional nëpërmjet programit master profesional në mësuesi në "gjuhë dhe komunikim" ka tentuar të zhvillojë një program i cili mundëson krijimin e një mjedisi profesional e bashkëkohor për studentët, në fushën e realizimit të edukimit gjuhësor me të gjitha parametrat bashkëkohorë. ⁴ Duke e quajtur edukimin gjuhësor shumë të rëndësishëm në zhvillimet e sotme arsimore, departamenti synon t'u japë mësuesve të ardhshëm kompetencat e duhura gjuhësore në fushën e komunikimit dhe kërkimit shkencor në gjuhën amtare me qëllimqëtë kapërcejë mangësitë e dukshme komunikuese që ka përgatitja e mësuesve aktualë në fakultetet e edukimit

³[Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]https://ascal.al/sq

⁴[Evidenca 42. Ligji Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë].



	<p>Departamenti me përgjegjësin e tij, Prof. Asc. Robert Gjemia ka krijuar një klimë konstruktive më marrëdhëniet e stafit akademik dhe administrativ, gjë e cila ndihet që ka ndikuar në shkëmbimin e lirë të ideve, në lirinë akademike në hulumtim, në mësimdhënie dhe në funksionimin e punës në terren. Realizimi me përgjegjshmëri dhe transparencë i këtyre vlerave pasurojnë dhe konsolidojnë programin e studimit.⁵</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Bazuar në qëllimet dhe misionin e institucionit “Barleti”, si dhe fushën e veprimtarisë mësimore, ky program studimi është ofruar në përputhje me to dhe prezantohet si në strategjinë e zhvillimit, ashtu edhe në rregulloren e institucionit dhe Departamentit të Edukimit dhe trajnimit Profesional. Anëtarët e departamentit gjatë diskutimit me grupin e vlerësimit të jashtëm theksuan se ky program është i mbështetur në praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.⁶</p> <p>Programi i studimit ka një kurrikul të mbështetur në mësimdhënien dhe nxënien bashkëkohore e cila është gjithëpërfshirëse dhe synon të ndihmojë edhe fëmijët me nevoja të veçanta që tashmë janë bërë pjesë e sistemit inkluziv të arsimit dhe politikave të reja arsimore. Më pranë të gjithë nxënësve, në bashkëpunim të vazhdueshëm me prindërit, në komunikim të nivelit të lartë me të gjithë aktorët e arsimit që ndihmojnë formimin e duhur të nxënësve me ide dhe kompetenca të reja në funksion të tregut të punës dhe ekonomisë së vendit. Kjo është deviza me të cilën programi Master “Gjuhë dhe komunikim” punon për të zbatuar në përputhje misionin me strategjinë e zhvillimit të universitetit dhe rregullores së institucionit.⁷</p> <p>Shprehitë e reja të të menduarit kritik, problemzgjdhjes, diskutimit shumëplanësh dhe debatit profesional shihet të jenë qendër e objektivave të përgatitjes së mësuesve të ardhshëm në këtë program studimi.⁸</p> <p>Ky program ofron dije profesionale për vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve në mënyrë individuale duke marrë në konsideratë jo vetëm llojet e ndryshme të inteligjencës, por edhe karakteristikave të ndryshme psikologjike, konjitive, gjuhësore, socializuese apo emocionale, duke e bërë mësuesin e ardhshëm mjaft të interesuar</p>

⁵[Evidenca 10.Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030].gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶[Evidenca 10.Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030].gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷Evidenca 2.1.a. Tabela e planit mësimor MPMGJK sipas veprimtarive]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸Evidenca .Raportiipunësdepartamentale I vitit 2022-2023.]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	për një mësimdhënie dhe nxënie në përshtatje me profilin e çdo nxënësi. ⁹			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Ky program i nivelit të dytë Master profesional në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” i është nënshtruar sfondit të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar, duke tentuar të përmirësojë cilësinë e arsimit në funksion të tregut të punës dhe kërkesave gjithnjë në rritje të formimit të specialistëve me kompetencat e nevojshme për punë dhe jetë.</p> <p>Qëllimi kryesor është diplomimi i profesionistëve të aftë në këtë fushë, ku i diplomuari në Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” me dy vite akademike ka mundësi punësimi si mësues në institucione arsimore parauniversitare publike dhe jopublike në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkollat e arsimit bazë; • shkolla të arsimit të mesëm të lartë; • institucione arsimore në nivel qendror dhe lokal; • institucione publike dhe jopublike që merren me edukim dhe trajnim; • organizata jofitimprurëse që kanë në fokus edukimin e fëmijëve; • aktivitet privat.¹⁰ 			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e	Neni 4 përcakton se “Misioni i UniBa është të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës , të aftë për sfidat e të tashmes dhe të ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në

⁹[Evidenca 2.1.b. Plani mësimor Master Profesional në MPMGJK]

<https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-mesuesi-ne-gjuhe-dhe-komunikim.html>

¹⁰[Evidenca 10.Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq.4]

<https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-mesuesi-ne-gjuhe-dhe-komunikim.html>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

<p>duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>ndryshim dhe në zhvillim të vazhdueshëm”.¹¹ (karakteristike kjo e zhvilluar gjerësisht në strategjinë e institucionit). Kurrikulat e këtij programi studimi përfshijnë lëndët bazë teorike që ndihmojnë formimin profesional gjuhësor, por një vend i veçantë i jepet dhe aftësimit praktik i cili e vë theksin tek zhvillimi i kompetencave më shumë se tek riprodhimi i njohurive..¹² Programi master u jep gatishmëri studentëve për të qenë përtej kulturës dhe traditës vendase, bashkëkohorë në mësimdhënie dhe nxënie të fushës gjuhë dhe komunikim, që në këto momente duhet të jetë prioritet i politikave arsimore në vendin tonë¹³</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Statuti përcakton qartë se “Vizioni i UniBa është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, si një aktor i zhvillimit, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë individë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv”.¹⁴ Institucioni synon të ofrojë në këtë program studimi formim profesional si dhe një përgatitje tërësore për të gjitha fushat e mësuesisë lidhur me zbatimin me efektshmëri të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar.¹⁵ Departamenti përkatës ka zbatuar me përpikëri udhëzimet kombëtare dhe evropiane në lidhje me klasifikimin dhe kodifikimin e të gjitha programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” me dy vite akademike ka këto karakteristika :</p> <ul style="list-style-type: none"> • është konceptuar mbi vazhdimin e programeve Bachelor të mësuesisë në gjuhë dhe letërsi shqipe dhe lëndët e edukimit pedagogjik; • tenton të plotësojë kërkesat e tregut aktual të punës; • kombinon jo vetëm teorinë me praktikën profesionale, por edhe përpiqet të formojë mësuesin si kërkues akademik • është një ofertë e re që i prezantohet tregut të formimit të mësuesve të ardhshëm me cilësitë e edukimit ndërkombëtar. .¹⁶

¹¹Statuti i Universitetit “Barleti”, faqe 1 ; [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹² RVB. MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024; [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³[Evidenca 10.1. Strategjia e ndërkombëtarizimit]; [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴Evidenca 1. Rregullore e fakultetit FSHSTS];[gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵[Evidenca 26. Të dhëna tabelore për numrin e programeve]; [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶[Evidenca 26. Të dhëna tabelore për numrin e programeve]; RVB MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024; [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Duke qenë se edukimi është një nga fushat prioritare të këtij universiteti, Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional me masterin profesional Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” ka mundësuar përputhjen e emërimit, organizimit dhe përmbajtjes së programit me fushën dhe drejtimin akademik të institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi realizohet nga stafi akademik që ka një ekspertizë profesionale brenda profilit të institucionit. Nuk rezulton që FSHSTS dhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional të ofrojnë “Master Profesional” jashtë profilit të UniBa-së.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Gjuhë dhe Komunikim” në objektivat e tij synon të përmbushë qëllimin e tij që lidhet “me përgatitjen e mësuesve të aftë në çështjet e mësimdhënies dhe nxënies, mësues të efektshëm, praktikantë reflektivë që nxënë gjatë gjithë jetës”</p> <p>Në objektivat e programit synohet që studentët të fitojnë kompetencat e duhura, profesionale të planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës, bazuar në kompetencat kyçe evropiane, të teorive dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të nxënies, të metodologjive ndërvepruese dhe atyre të nxitjes së të menduarit kritik, sipas filozofive më të suksesshme të edukimit, por dhe njohje të thelluar të veçorive psikologjike të fëmijëve, të adoleshentëve dhe të rriturve, etj</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional me anë të Qendrës së Universitetit “Barleti Training Testing Center” (BTTC) ofron trajnime të vijueshme, të akredituara nga MAS dhe nga MFE që lidhen me personelin arsimor parauniversitar dhe atij të arsimit dhe formimit profesional (AFP), Një specifikë e universitetit “Barleti” është se, Departamenti në fjalë ofron disa aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prej 5 vitesh aplikimin e Shkollës së Drejtorëve në bashkëpunim me Shkollën e Drejtorëve në Tiranë, mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF). • ndryshe nga shumë IAL të tjera UniBa ofron disa programe që janë kombëtare dhe në shërbim të mësuesve të të gjithë

Qudo

fr

	vendit si p.sh Programi i Vazhduar i Formimit Psiko-Pedagogjik i licencuar nga MAS. ¹⁷			
Konkluzione	<i>Rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional, që është njësia përgjegjëse për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", ka përvojën, kapacitetet, si edhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit të studimit. Programi i Studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UniBa, si edhe në përputhje me fushën akademike të studimit të FSHSTS dhe të Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional që mbulon zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet kryesore rregullatorë të institucionit që janë Rregullorja e UniBa, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, Rregullorja e Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, si edhe Rregullorja e Programit të studimit. Rregullorja e UniBa përcakton kriteret kryesore të funksionimit të universitetit në tërësi, duke treguar se institucioni e zhvillon veprimtarinë përmes zbatimit të vendimeve, urdhrave edhe udhëzimeve të veçanta. Kjo rregullore përcakton edhe disiplinimin e marrëdhënieve të organeve dhe autoriteteve drejtuese me njësitë përbërëse të tij. Rregullorja e UniBa-së përcakton se rregulloret e brendshme të njësive kryesore dhe të njësive bazë miratohen nga Senati Akademik, ndërsa rregulloret e brendshme të funksionimit të strukturave ndihmëse akademike me karakter administrativ rregullohen përmes rregullores së njësive kryesore.

¹⁷RVB MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024; | gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve përcaktohet se subjekte të rregullores së fakultetit janë organet dhe autoritetet drejtuese të FSHSTS, personeli akademik dhe administrativ, këshillat, komisionet, studentët, si edhe bashkëpunëtorët e fakultetit. Gjithashtu, në rregulloren e fakultetit përcaktohet me detaje mënyra e rregullimit dhe e kontrollit të jetës së brendshme të karakterit akademik dhe administrativ të njësisë kryesore dhe asaj bazë.¹⁸</p> <p>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit duke bërënjëndarjetë rregullt tëdetyrave dhe përgjegjësiive respektive..¹⁹</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Rezulton se në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues, UniBa ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi prej vitesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Programi MP në “Gjuhë dhe Komunikim” është i mbështetur në hapjen dhe vazhdimin e tij në studimin përkatës që identifikon nevojat e thellimit të kompetencave profesionale në fushën e mësuesisë, për një cilësi më të lartë të sistemit arsimor parauniversitar dhe përgatitjen e studentëve me parametra kombëtarë dhe ndërkombëtarë për tregun e punës</p> <p>Politika e bashkëpunimit me institucionet lokale dhe ndërkombëtare janë në varësi të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi. Fitimi i kompetencave profesionale që u kërkohet studentëve mund të arrihet përmes të nxënit teorik dhe praktik , metodave bashkëkohore dhe nxitjes së të menduarit të pavarur dhe kritik. Të gjitha këto cilësi zhvillohen nëpërmjet bashkëpunimit të përhershëm me aktorët ndërkombëtarë dhe ata lokalë që sigurojnë vizione të reja, praktika efektive dhe kërkime të vazhdueshme në fushën e gjuhës dhe komunikimit.</p> <p>Zbatimet praktike në shkollë, zhvillimi i detyrave krijuese dhe studimore arrihen vetëm nëpërmjet shkëmbimit të ideve të reja për njohjet teorike dhe praktike. Kjo kërkon një platformë të gjerë marrëveshjesh të larmishme me vlerat e institucioneve ku njohuritëpraktikohen dhe marrin jetë.²⁰</p>

¹⁸Evidenca 1.2. Rregullore UniBa];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰[Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Qeto

fr

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për zhvillimin e praktikës profesionale për të gjithë studentët që ndjekin programet e studimit që zhvillohen nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve pranë UniBa, janë lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi, sipas të cilave përcaktohen modalitetet e kryerjes prej studentëve të praktikave profesionale pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe jopublike, si edhe të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve.^{21/22}</p> <p>Për sa i takon mobilitetit, pedagogë të Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional kanë zhvilluar mësimet dhe prezantime në universitete jashtë vendit, për një javë ose semestër në kuadër të projektit Erasmus +, gjithashtu, edhe pedagogë të huaj kanë zhvilluar disa module në programet e studimit master.²³ Mirëpo, duke qenë viti i parë i zbatimit të këtij programi studimi nuk shihet të ketë pasur shkëmbime të studentëve në programin Ersamus+, por nga bisedat me pedagogë të masterit tregohet se është përparësi mobiliteti i studentëve në të ardhmen.²⁴</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional, si njësi bazë që mbulon edhe zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", në fund të çdo viti akademik zhvillon analizën e punës vjetore të tij, në të cilën shqyrtohet edhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, edhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve paraqet raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore, në të cilin përfshihet edhe veprimtaria vjetore e Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.</p> <p>Në këto raporte, analizohet ecuria e cilësisë mësimore që vjen si rezultat i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në lidhje me vitin akademik të përfunduar, së bashku me problematikat e implementimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.²⁵</p> <p>Studentët zhvillojnë praktikat e tyre profesionale në institucione arsimore me të cilat ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi.²⁶</p> <p>Numri i këtyre marrëveshjeve është i madh. Studentët në të shumtën</p>

²¹Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²[Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e praktikës Master];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³[Evidenca 32. c. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studenteve];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴RVB MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024; <https://>]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵Evidenca 50.6 Raportvjetor per cilesine.pdf.pdf]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶Evidenca 16.8 Raport me vlersimin e studenteve per lendensem II.pdf.pdf; <https://>]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

	e rasteve ndjekin praktikën profesionale në institucionet me të cilët UniBa bashkëpunon ²⁷ Ky është një tregues i përfitimeve nga marrëveshjet, të shkruara apo të pashkruara. ²⁸			
Konkluzione	<i>Kuadri i përgjithshëm rregullator i UniBa është i plotë dhe ekziston një ndarje e qartë e detyrave që duhet të kryejë çdo njësi e institucionit. Në funksion të zbatimit të programit të studimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë brenda dhe jashtë vendit. Në përfundim të çdo viti akademik, nga njësia kryesore dhe njësia bazë, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë së formimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatorë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim " është i organizuar në lëndë mësimore të cilat ndahen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmyllëse. Për t'u nënvizuar në këtë program studimi janë lëndët e aftësimit praktik në gjuhë, letërsi dhe komunikim të cilat duke iu shtuar praktikave profesionale i japin programit vlera të karakterit

²⁷Evidenca 50.7 Miratimi i raportit vjetor për vitin akademik 2022-2023.pdf.pdf; [gjetet në: <https://ascal.al/sq>

²⁸[Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]; [gjetet në: <https://ascal.al/sq>

<p>fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>problemzgjdhës dhe mendimit kritik. Përfundimi me sukses i Programit të Studimit parashikon dy vite akademike dhe në përfundim të tij studenti fiton 120 kredite ECTS.²⁹ Struktura e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" është në përputhje me VKM nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar. 30</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit për ciklin e dytë të Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" është i përqendruar në zhvillimin e një sërë kompetencash të veçanta në fushën e gjuhës dhe komunikimit, fushë kjo mjaft e rëndësishme në momentet që po përjeton shkolla dhe shoqëria jonë. Ky program ka për qëllim ofrimin e njohurive të thelluara dhe aftësive të përparuar në fushën e studimit ose punësimi. Synimi kryesor është të përgatisë mësues me një gamë të gjerë të shprehive dhe aftësive që janë të nevojshme në ushtrimin e profesionit. Në këtë program, studentët përfitojnë kompetencat e kërkuara dhe kuptimin kritik të teorive dhe parimeve akademike në fushën e gjuhës dhe pedagogjisë. Përveç kësaj, ata zhvillojnë aftësi që janë esenciale për zgjidhjen e problemeve komplekse arsimore. Me përqendrimin në një trajnim të thelluar akademik dhe profesional, ky program i siguron studentëve një bazë të fortë të dijeve dhe aftësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave.^{31, 32}</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" përcakton se ngarkesa e praktika profesionale vlerësohet 12 kredite ose 270 orë, nga të cilat 250 zhvillohen në institucion dhe 20 orë në funksion të përgatitjes së raportit të praktikës. Vendosija e lëndëve në planin mësimor të këtij programi i ka qëndruar korrektësisht plotësimin të këkesave me Lëndë bazë të synuara për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, Lëndë karakterizuese që përgatisin për disiplinën shkencore, Lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me Zgjedhje; Lëndë plotësuese, të cilat ndërtojnë ura midis profesionit dhe teknologjisë</p>

²⁹RVB MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁰[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³¹RVB MësuesinëGjuhëdheKomunikim. 2024;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³²[Evidenca 2.1.a. Tabela e Plani mësimor MPMGJK];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>dhe bëjnë lidhje efektive midis mësimit dhe praktikës profesionale dhe Teza e diplomës, e cila synon t'u ofrojë studentëve mundësinë të thellohen në një qasje të veçantë.</p> <p>Ngarkesa e dedikuar aftësimit gjuhësor, letrar dhe komunikues vlerësohet me 12 kredite të tjera, përveç praktikave duke i dhënë si veçanti theks jo vetëm dijeve, por mbi të gjitha krijimit të aftësive praktike. .</p> <p>Studentët e zhvillojnë praktikën në një ose disa institucione, ose në institucionin ku janë të punësuar që mund t'i përkasë një qyteti tjetër nga Tirana ku është i vendosur UniBa.³³³⁴</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" me dy vite akademike është pjesë e formimit të atyre studentëve që kanë studiuar bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi.</p> <p>Fusha e detajuar e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" përfshin kualifikime ndërdisiplinore që integrohen në arsim. Në këtë këndvështrim, programi i studimit është me natyrë ndërdisiplinore dhe GVJ nuk gjen referencë në kriterin 4 të Standardit II.1.³⁵</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së</p>	<p>Programi i studimit i Ciklit të Dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim", referuar Planit Mësimor³⁶ është i organizuar me 120 kredite dhe mbi 25% të krediteve të lëndëve i shërbejnë formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, programi i studimit i Ciklit të Dytë Master Profesional në " Gjuhë dhe Komunikim" është program me natyrë ndërdisiplinore dhe unik në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë shkak, nuk mund të krahasohet me programe të tjera që zhvillohen në fushën e mësuesisë, pavarësisht se si program masteri të cilin po analizojmë</p>

³³[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁴Evidenca 2.1.a. Tabela e Plani mësimor MPMGJK, sipas veprimtarive/ [Evidenca 2.1.b.Plani Mësimor MPMGJK]; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁵Evidenca 2.1.b. Plani mësimor MPMGJK; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁶"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>është mbështetur në planin mësimor me 120 kredite të Universitetit të Tiranës dhe shihet që ka një sasi lëndësh të ngjashme me të³⁷</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në “Gjuhë dhe si program i ciklit të dytë të studimeve, realizohet me 120 kredite dhe ofrohet me kohë të plotë në katër semestra. ³⁸Ndërtimi dhe ecuria e programit të studimit është në përputhje me kuadrin ligjor të Ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” me dy vite akademike respekton kriterin 5 sepse ai ka 70 % përmbajtje të ngjashme që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, atë të mësuesisë dhe sipas sistemit të kodifikimit përmbush plotësisht kriteret e diplomimit në mësuesi.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi i përket nivelit 7 të Kornizës së Kualifikimit. Departamenti është përpjekur të realizojë kodifikimin e programeve të studimit që ai mbulon, ku përfshihet edhe ai programit që ne vlerësuam.</p>

³⁷Evidenca 2.1.b. Plani mësimor MPMGJK / Evidenca 4. Studimi i tregut i MPMGJK ; gjendet në:

<https://ascal.al/sq>

³⁸[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

te j kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.									
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi që UniBa ofron Master në Mësuesi “Gjuhë dhe Komunikim” nuk është program studimi i përbashkët me asnjë institucion tjetër.								
Konkluzione	<i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kodifikimi i programit është bërë në përputhje me kërkesat ligjore. Programet lëndore tregojnë kodin e çdo lënde të veçantë</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet	Struktura akademike e UniBa-s formohet nga katër fakultete dhe 13 departamente; struktura e njësive kërkimore formohet nga katër institute dhe dy qendra kërkimore. UniBa është ristrukturuar ³⁹ me miratimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës me shkresën nr. 2365 Prot., datë 12.04.2006 dhe me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 202, datë 25.05.2015. ⁴⁰

³⁹[Evidenca 1.4.d. Urdhër MASR, nr. 213 datë 3.7.2020,“Riorganizimi për ndryshimin e statusit”];gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁰Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 288, datë 4.09.2009

[Evidenca 1.4.c. Akreditimi institucional UMB Vendimi Bordit të Akreditimit, nr. 9, datë 7.04.2017]; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Rezulton se njësia bazë që është përgjegjëse për administrimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" plotëson kërkesat e vendosura në Vendimin e MAS nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", sipas të cilit kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që *Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.*

Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 përbëhet si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1
Prof. As.Dr	4	3	5	4
Dr./PhD.	12	12	13	23
Msc (dr.proc)	19	18	19	13
Totali	36	34	38	41

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit. Ai e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Universiteti është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 288, datë 4.09.2009 dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 9, datë 7.04.2017.

Të dhënat për Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 janë si më poshtë.

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. As.Dr	1	1	2	1
Dr./PhD.	4	1	4	3
Msc.	2	-	2	-
Totali	7	2	8	4

Rekomandohet që pedagogu me MSc (nuk është paraqitur në tabelën përmbledhëse të stafit të MPMGJK) të ndjekë procesin e doktoraturës ose të zëvendësohet sepse prania e tij në programet e studimit Master bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”*. Raporti personel akademik efektiv /studentë në nivel njësie kryesore është në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.⁴¹

Universiteti “Barleti” është licencuar më 12.08.2005 me VKM Nr. 571 dhe ka filluar veprimtarinë në tetor 2005. Universiteti është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 288, datë 4.09.2009 dhe me Vendim të Bordit të Akreditimit, nr. 9, datë 7.04.2017.⁴²

Konstatohet se numri i PAE është më se i mjaftueshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit. Gjithashtu, konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) që përgjigjet për mbarëvajtjen e zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe

⁴¹[Evidenca 23. Të dhëna tabelore për 3 vitet e fundit të personelit akademik MPMGJK, Tabela 1 & 2]/

[Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën, tabela 12 MPMGJK];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴²[Evidenca 1.4.e. AkreditimiinstitucionalUMB,VendimiBordittëAkreditimit, nr. 9, datë 7.04.2017]; ;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	Komunikim " mbulon mbi 90% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi ⁴³ .
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezulton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP), si njësi përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë në Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", nuk angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, por e mbulon këtë veprimtari me burimet e brendshme. ⁴⁴ Gjithashtu, rezulton se nisur nga veçoritë e programit të studimit, prej DSHETP mundësohen vetëm praktika profesionale, ndërsa nuk planifikohen dhe as realizohen praktika laboratorike dhe klinike. Për zhvillimin e praktikave profesionale janë ngarkuar disa anëtarë të stafit. UniBa ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikave. ⁴⁵
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Rregullorja e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP), përcakton se roli i Koordinatorit të programit të studimit është i detyrueshëm. ⁴⁶ Çdo departament ka nga një koordinator, i cili koordinon punën me praktikën, marrëdhëniet me përgjegjësin, pedagogët etj. Ndër përgjegjësitë që Dr. Qafa e cila është koordinatorë kapërfshihet edhe ajo që lidhet me ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Detyrat e koordinatorit të Departamentit apo të programit të studimit zënë një vend të rëndësishëm në rregulloren e UniBapërmarrëdhëniet dhe komunikimin, si me drejtuesin e njësisë përgjegjëse, ashtu edhe me stafin akademik, studentët dhe sekretarinë mësimore të institucionit.
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) , si njësi bazë e caktuar për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në Master Profesional Mësuesi në "Gjuhë</i>

⁴³[Evidenca 24. Personeli akademik, MPMGJK, Tabela 6.1]/ [Evidenca 25. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën, tabela 4 MPMGJK];]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁴Evidenca 1. Rregullore fakulteti FSHSTS] ;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁵[Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit] ;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁶[Evidenca 1.1.Statuti i Universitetit "Barleti"] ;]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Coets

[Signature]

	<i>dhe Komunikim " përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. E gjithë veprimtaria e departamentit për përmbushjen e standardeve të kësaj fushe karakterizohet nga korrektësia dhe zbatimi faktik i ligjshmërisë në fushën e arsimit të lartë .</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional si njësi bazë ka dokumentacion të plotë për programin MP në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" duke filluar nga shkresa që autorizon hapjen e programit pas aplikimit. Si njësi bazë, ky departament disponon rregulloren e programit, plan- programin, të dhënat për stafin akademik, ngarkesën mësimore, numrin e studentëve të regjistruar, shërbimet që u jepen atyre, raporte të monitorimit të performancës, etj</p> <p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë dhënë të plota dhe me të gjitha detajet e duhura në këtë dokumentacion.</p> <p>Informacionet për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit gjenden të publikuara në <u>faqen zyrtare të "Universiteti Barleti"</u> https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html (http://umb.edu.al/akademia-umb.html)</p> <p>Informacionet më të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë në Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" gjenden në dokumentet kryesore rregullatorë të UniBa-së dhe të njësisë kryesore/bazë, që më poshtë renditen sipas shkallës hierarkike të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Rregullorja e UniBa⁴⁷-së; ○ Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS);⁴⁸

⁴⁷Evidenca 1.2 RREGULLORE E UNIBA.pdf.pdf Jgendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁸Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit.pdf.pdf <https://ascal.al/sq>

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Rregullorja e Departamentit të Shkencave Të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ;⁴⁹ ○ Rregullorja e Programit të Studimit.⁵⁰ <p>Përveç dokumenteve të mësipërme rregullatorë, të dhëna më të detajuara jepen edhe në planin mësimor të programit të studimit, kurrikulën, si edhe në syllabuset e lëndëve.⁵¹</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani Mësimori Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe komunikim" përmban në pjesën hyrëse, objektivat e programit të studimit dhe më pas në planin mësimor tregohet semestri kur zhvillohet lënda, struktura e lëndës, emri i lëndës, ngarkesa mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, kategorinë ku përfshihet lënda (A-E). Gjithashtu, plani mësimor përcakton edhe numrin e lejueshëm të krediteve për çdo lëndë, si edhe orët mësimore që zhvillohen në auditor dhe jashtë tij.⁵²</p> <p>Programi i studimit organizohet në lëndë dhe praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të dhënat e programit përcaktohen në mënyrë më të detajuar nëkurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit, si dy dokumente bazë të përcaktimit profesional të programit të studimit. .</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Shqyrtimi i dokumentacionit duke filluar nga rregullorja e MP dhe deri tek syllabuset vërtetojnë një gjë të tillë.</p> <p>Studentët e interesuar mund të informohen mbi kriteret e përmendura më sipër edhe përmes informacionit të dhënë në faqen zyrtare të UniBa-së.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo</p>	<p>Dokumentacioni i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" përmban edhe programet lëndore (syllabuset), të cilat janë ndërtuar mbi bazën e të gjithë elementëve të kërkuar nga VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".⁵³ Në të gjitha syllabuset, të cilat janë hartuar sipas</p>

⁴⁹Evidenca 3.1 Rregullore e Departamentit.pdf.pdf <https://gjendet.net>; <https://ascal.al/sq>

⁵⁰rregullore per programin e studimit.pdf.pdf gjendet.net; <https://ascal.al/sq>

⁵¹ 7.2.Plani mesimor ne exel.pdf.pdf <https://gjendet.net>; <https://ascal.al/sq>

⁵²Evidenca 3. Rregullore e programit të studimitMPMGJK]; gjendet.net; <https://ascal.al/sq>

⁵³[Evidenca 44. VKM nr.41, datë 24.01.2018]]gjendet.net; <https://ascal.al/sq>

<p>orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>anekseve të VKM-sa nr.41/2018, tregohet emri i lëndës, kodi i saj, pedagogu përgjegjës, ngarkesa, tipologjia e lëndës, viti akademik, lloji i lëndës, temat themelore, qëllimet dhe rezultatet e të nxënit, format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit, frekuentimi, si edhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.⁵⁴</p> <p>Për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet programi i detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i departamentit. Programet lëndore hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse⁵⁵</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në dokumentet e rishikimit të programeve dhe kurrikulave nga ana e Departamentit vërehen diskutime rreth ecuresë së programeve dhe sugjerimeve të bëra për përmirësimin e tyre në mënyrë që t'i përgjigjen me rritje të cilësisë procesit mësimor. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët, rregull ky tashmë që përfshin punën e të gjitha universiteteve⁵⁶</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjithë dokumentacioni i plotë rregullator i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" përmban gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit të tillë si planin mësimor, ngarkesën mësimore, programet lëndore, si edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Rezulton, gjithashtu, se programi i studimit i nënshtrohet rishikimit dhe përditësimit/riorganizimit në mënyrë të vazhdueshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

⁵⁴[Evidenca 45. VKM Nr. 185, datë25.3.2021]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁵Evidenca 45. VKM Nr. 185, datë25.3.2021]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁶[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]gjendet në: <https://ascal.al/sq>




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), Programi i Studimit i Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" pozicionohet në nivelin 7- të KSHK-së. Gjithashtu, në Rregulloren e programit të studimit⁵⁷ përcaktohet se "Masteri Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" synon një kualifikim më të thelluar teorik/praktik të studentëve.</p> <p>Bisedat me studentët, një pjesë e të cilëve janë të punësuar tregoi se ata aktualisht janë të kënaqur me performancën e tyre në tregun e punës duke renditur si përparësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lehtësinë me të cilën përshtaten me kërkesat dhe udhëzimet ministeriale apo lokale; • Komunikimin e mirë me nxënësit dhe prindërit; • Vetëvlerësimin e tyre profesional dhe intelektual; • Rezultatet cilësore të të nxënit. <p>Ky Master Profesional i përgatit studentët për profesionin e tyre mësimdhënës duke i dhënë rëndësi të veçantë profesionale praktikave pedagogjike që zhvillohen në shkolla, të vëzhguar nga udhëheqësi i praktikës dhe nga mentori i institucionit.⁵⁸</p> <p>Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programin.⁵⁹</p> <p>Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar me 120 kredite (30 kredite për semestër) dhe 3000 orë mësimore (1500 orë për vit akademik), shpërndarë në orë leksionesh dhe seminaresh brenda dhe jashtë auditorit, orë studimi individual, etj në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Është ligji nr 80, datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe neni nr 83, pika 2 që përcakton se programet master të mësuesisë duhet të jenë me 120 kredite.</p> <p>I konceptuar në këtë mënyrë, përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" u jep të diplomuarve:</p> <ul style="list-style-type: none"> o mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejtë në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin Master Profesional;

⁵⁷[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁸[Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e Praktikës]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁹[Evidenca 2.1.b. Plani Mësimor MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave⁶⁰ është bërë e studiuar për të motivuar thellimin në njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, si dhe për të lejuar dhe lehtësuar punësimin e studentëve, gjë që konfirmohet edhe nga përqindja e lartë e të regjistruarve të punësuar.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore për studentët në dy vite dhe 4 semestra, vlerësimi në 60 kredite për vit dhe 30 kredite për semestër dhe planifikimi i studiuar i orëve mësimore mundëson arritjen e objektivave të programit të studimit MP në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” duke marrë kështu rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.⁶¹ Ngarkesat janë konform kërkesave ligjore.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” është hartuar mbështetur në përvojat më të mira evropiane dhe vendase në fushën e mësuesisë.⁶² Për të mundësuar arritjen e objektivave formues, programi i studimit ofron një ndërthurje të mirëmidis formimit teorik dhe praktik, gjë që e kemi theksuar disa herë sepse është një program që i jep një vend të veçantë zhvillimit dhe aftësimin praktik të studentëve në krahasim me shumë programe master të tjerë të realizuar nga shumë IAL të tjera në vend. ⁶³</p>

⁶⁰[Evidenca 25. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesënMPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶¹Evidenca 2.1.a. Plani dhe programi sipas veprimtarisë formuese të programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶²Evidenca 2.1.a. Plani dhe programi sipas veprimtarisë formuese të programit të studimit MPMGJK]] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶³[Evidenca 2.1.b. Plani mësimor MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Institucioni shihet të rinovojë herë pas here programet lëndore me qëllim përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p>Duke qenë se në fushën e gjuhës dhe komunikimit nuk ka tekste universitare të kohëve të fundit në gjuhën amtare që do të ndihmonin kontaktin e studentëve me literaturën bashkëkohore, pedagogët përpiqen të pajisin studentët e tyre me leksione të shkruara dhe të përcjella përmes internetit.</p> <p>Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me stafin akademik që zhvillon programin e studimit dhe me studentëqë ndjekin këtë master, u konstatua se literatura bazë dhe ajo ndihmëse është përshtatur/ndryshuar, duke marrë për bazë literaturën e viteve të fundit.⁶⁴</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" bazohet në VKM-në nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.</p> <p>Në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Trajnimit Profesional⁶⁵, si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit⁶⁶ parashikohen aftësitë dhe kompetencat që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.⁶⁷</p> <p>Departamenti përpiqet dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në bibliotekat e institucionit, por edhe duke pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p>Nga ana tjetër paraqitja e modeleve dhe praktikave mësimore bashkëkohore u jep studentëve mundësi të përmirësojnë aftësitë e tyre mësimdhënëse në punën që ata bëjnë.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MP në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" krijon hapësirat e nevojshme për aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale në fushën e mësuesisë duke përgatitur vizionarë dhe operatorë të aftë në rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar</p>

⁶⁴[Evidenca 30. Lista e teksteve – Departamenti i Shkencave të Edukimit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁵ "Evidenca 3.1 Rregullore e Departamentit.pdf.pdf]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁶ "rregullore per programin e studimit.pdf.pdf https://gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁷[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>




prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Studentët përgatiten në mënyrë të vazhdueshme edhe për punën me komunitetin arsimor duke fituar kështu edhe statusin trajnues ndaj tij.		
Konkluzione	<p><i>Përfundimi me sukses i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" u mundëson studentëve që të vijojnë plotësimin e profilit të tyre akademik për në nivelet më të larta të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (nivelet 7) apo u jep atyre mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejtë në tregun e punës.</i></p> <p><i>Programi i studimit ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë dhe programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim fitimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me pjesëtarë të strukturave drejtuese dhe personelin akademik të Departamentit të Shkencave Sociale dhe Trajnimit Profesional, rezultoi se pranë UniBa-së funksionon një rrjet i suksesshëm i studentëve dhe ish-studentëve të cilët angazhohen së bashku me pedagogët dhe organizojnë takime periodike.</p> <p>Në këtë departament ushtron veprimtarinë Bordi i Karrierës⁶⁸ me ish-studentët dhe personalitete në edukim, i cili ka si qëllim edhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve në funksion të integritit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës. Ky Bord tenton të luajë rol domethënës për punësimin e studentëve të fushës së edukimit, që diplomohen dhe certifikohen në universitetin UniBa,</p> <p>Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti ka të zhvilluar kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të</p>

⁶⁸[Evidenca 28. Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës, DSHETP]] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>studimit dhe këtë e ka dëshmuar me ndryshimet 20% në programet e tjera. Praktika e punës për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor zhvillohet në bashkëpunim me NJZHKC⁶⁹. Zakonisht, sikurse ndodh në të gjitha IAL, në përfundim të vitit akademik realizohet një pyetësor me studentët,⁷⁰ prej përgjigjeve të të cilipërftohet informacioni i nevojshëm si për vlerat e programit mësimor , ashtu edhe për punën e pedagogëve në punën e tyre të përditshme me studentët. Mbi bazë të këtyre sondazheve ngrihen hipoteza, bëhen sugjerime dhe më pas punohet për përmirësimin e veprimtarisë akademike brenda institucionit⁷¹.</p> <p>Gjithashtu, nga bisedat me stafin akademik doli se departamenti harton në mënyrë periodike analizën e tregut dhe Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit.</p> <p>https://umb.edu.al/news1166.html</p> <p>Gjatë gjithë veprimtarisë së tij akademike, duke filluar që nga identifikimi i nevojave dhe deri tek analiza e kurrikulës apo praktikave pedagogjike , departamenti bashkëpunon me partnerët e jashtëm, pjesë e “Barleti Partners Group”.⁷² Ata zhvillojnë së bashku një sërë leksionesh të hapura të cilat pasqyrohen në faqen e internetit , me këtë adresë:</p> <p>http://umb.edu.al/kerkimi-institute-dhe-qendra-umb.html</p> <p>Departamenti, po ashtu ka një veprimtari shumë aktive në planin e shkëmbimeve të studentëve dhe pedagogëve në universitete të ndryshme nëpërmjet Erasmus +.⁷³ Praktikrat e përfituara nga këto marrëdhënie ndikojnë pozitivisht në shumë drejtime si tek studentët, ashtu edhe tek pedagogët.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, dhe siç u konkludua nga bisedat me studentët, ata kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e tyre jo vetëm për përmirësimin e programeve të studimeve, por edhe për detaje të përditshmërisë së tyre në funksion të rritjes së cilësisë akademike.⁷⁴</p>

⁶⁹Evidenca 16.2 Rregullore e NjZHKC.pdf.pdf]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁰[Evidenca 16.4. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët].]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷¹[Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit te studentit 21-22, sem. I] / [Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit te studentit 21-22, sem. II]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷²[Evidenca 4. Studimi i tregut të punës për programin e studimit të MPMGJK] [Evidenca 5. Plan Strategjik i Zhvillimit të Programit të Studimit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷³[Evidenca 32.b. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit & studentëve]] :gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁴[Evidenca 16.5. Formulari i vlerësimit koleg me koleg; Peer Evaluation of Teaching] <https://ascal.al/sq>

<p>përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>(Si do punohet për projektet, Si do të frekuentohen praktikat mësimore pranë shkollave në afërsi të vendbanimeve të tyre, Si do të konsultohen me pedagogun udhëheqës në realizimin e detyrave të ndryshme, etj). UniBa organizon çdo vit një proces anketimi⁷⁵ me studentët për të tërhequr idetë dhe vizionet e tyre për zhvillimet mësimore.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, kryen takime të vazhdueshme me pedagogët dhe studentët duke i ballafaquar ata me njëri tjetrin për të zbuluar dhe analizuar pikat e forta dhe të dobëta, lidhur me ecurinë e programit mësimor.⁷⁶ Në këto takime shkëmbehen ide dhe bëhen propozime për funksionimin dhe përmirësimin e tij.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më parë në këtë RVJ, programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" është realizuar në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, me qëllim kryesor përshtatjen e programeve lëndore në përputhje me planin strategjik të institucionit dhe me ndryshimet ligjore.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" është rezultat i nevojës që është ndjerë në fushën e arsimit për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për mësues të diplomuar me "Master profesional".⁷⁷</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Shkencave Sociale dhe Trajnimit Profesional, në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke qenë në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të tjerë të interesuar si studentët, pedagogët dhe partnerë të tjerë të shoqërisë dhe komunitetit të dijes.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

⁷⁵Evidenca 16.4. Formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët] : [gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁶Evidenca 16.7. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22, sem. I] / [Evidenca 16.8. Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22, sem. II] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁷[Evidenca 4. Studimi i tregut të punës për programin e studimit të MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Nga bisedat e zhvilluara në Institucion, u konstatua se njësi përgjegjëse për këtë program ndërmerr një rol të rëndësishëm në mbështetjen e grupeve lëndore dhe është gjithmonë në përpjekje për të realizuar projekte inovative kërkimore-shkencore. Kjo njësi koordinon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë me strukturat kërkimore të tjera brenda dhe jashtë fakultetit, duke synuar realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e studimit nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit të saj përcaktohet se Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim" synon një kualifikim më të thelluar teoriko/praktik të studentëve krahasuar me ciklin e parë, si edhe synon, gjithashtu, studime të thelluara për mësimdhënien, mësimnxënien, si edhe edukimin e të rriturve.</p> <p>Duke u fokusuar në rritjen e cilësisë akademike dhe në vënien në qendër të studentit dhe komunitetit arsimor, programi master "Gjuhë dhe Komunikim" kërkon të krijojë një traditë pozitive në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Siç është paraqitur edhe në RVB, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka organizuar projekte, konferenca⁷⁸, si edhe fushata kombëtare/lokale në përputhje me planin strategjik të UniBa-s, ku janë angazhuar personel akademik i vetë universitetit, personel akademik i ftuar, studentë, apo edhe aktorë të tjerë të interesuar.</p> <p>Kualifikimet e stafit të angazhuar në realizimin e programit të studimit janë me parametra cilësorë; ata janë me tituj dhe grada shkencore, efektive dhe të njohur në fushat e lëndëve dhe moduleve që mbulojnë duke iu përgjigjur kështu kërkesave për një drejtim cilësor të programit të studimit.</p> <p>Baza e të dhënave për kërkimin shkencor mundëson monitorimin në kohë reale të veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe njësive të UniBa-së, si edhe rankimin vjetor të njësive, bazuar në këtë vlerësim.</p> <p>Sipas rregullores, organi më i lartë i kërkimit shkencor në UniBa është Këshilli i Kërkimit Shkencor. Gjithashtu, çdo departament cakton nga personeli akademik i tij një "Koordinator për kërkimin".</p>

⁷⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Njoftime për konferencat shkencore”, ASCAL, Evidenca 72. Parë më nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Gjatë vlerësimit të jashtëm, koordinatori i njësisë bazë është person kontakti që ndjek hedhjen e të dhënave në portalin universitar.</p> <p>Mbi bazën e të dhënave të kërkimit shkencor bëhen analiza në njësitë bazë dhe ato kryesore të UniBa.</p> <p>Këshilli i Kërkimit Shkencor, si institucion i vlerësimit të brendshëm të cilësisë së kërkimit shkencor bën, në prani të koordinatorëve të kërkimit të njësive bazë, vlerësimin e përvitshëm dhe rankimin e njësive të UniBa.⁷⁹</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Përzgjedhja e pedagogëve në lëndët dhe modulet përkatëse të programit të studimit MP në “Gjuhë dhe Komunikim” është bërë në përputhje me specializimet e tyre brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu janë marrë në konsideratë kërkimet e tyre shkencore dhe përvojat aktive në fusha të caktuara. Kontributi i tyre me botime, manual, etj u ka dhënë mundësi të konkurrojnë brenda departamentit në mbulimin e natyrës dhe specifikës së moduleve të programit.</p> <p>Institucioni “Barleti” ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe shkolla të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht , departamenti ka disa marrëveshje bashkëpunimi me shkolla publike dhe jopublike, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor.UniBa merr përsipër: përgatitjen e paketës/ sigurimin e pedagogut mentor / ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë/ ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.</p> <p>Shkollat marrin përsipër: mundësimin e zhvillimit të praktikave në këtë institucion duke firmosur marrëveshjen/ caktimin e një mbikëqyrësi të studentëve/ vënien në dispozicion të materialeve dhe mjeteve ndihmëse për zhvillimin profesional të studentëve/ angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave të institucionit/ dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë. ⁸⁰</p> <p>Çdo vit akademik studentët me punimet e tyre janë pjesë e konferencave ndërstudentore në universitete jashtë vendit në kuadër të projektit Erasmus+. ⁸¹</p> <p>Studentët e këtij programi janë të përfshirë në trajnime dhe leksione të hapura që organizohen nga departamenti dhe nga BTTC⁸².</p>

⁷⁹Evidenca 16.4.Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁰[Evidenca 32.a. Lista e Konferencave dhe ëorkshopeve]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸¹Evidenca 32.b. Lista e aktiviteteve ndërkombëtare 2015-2020]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸²Evidenca 32.e. Projekte të zbatuara dhe në proces Grupi “Barleti”]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	Në kuadër të mobilitetit të studentëve të projektit Erasmus +, studentët janë dërguar në Spanjë për një javë ose një semestër të tërë. ⁸³									
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin shoqërues i RVB-së, rezulton se në Pasqyrën Financiare të UniBa-së gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nuk është i pasqyruar <i>Granti për kërkim dhe kontratat</i>.⁸⁴Gjithashtu, nga bisedat dhe takimet në institucion me personelin akademik që mbulon zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka një fitim të papërfillshëm financiar nga MP në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" e megjithatë kërkohet prej tij të mbulojë një pjesë të vogël të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti.⁸⁵ (një shembull i mirë në këtë drejtim është UAMD)</p> <table border="1" data-bbox="584 954 826 1317"> <tr> <td>Shuma Arkëtuar</td> </tr> <tr> <td>9,000 €</td> </tr> <tr> <td>5,400 €</td> </tr> <tr> <td>3,600 €</td> </tr> <tr> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> </tr> <tr> <td>Fitimi 154 €</td> </tr> </table> <p>Për t'iu përgjigjur kërkesave të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", sipas të cilit kërkimi shkencor është kriter i vlerësimit institucional, rankimit dhe financimit të IAL-ve, rekomandohet që UniBa pas vendimit të akreditimit të parë duhet të rrisë buxhetin e parashikuar në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", në tre zëra, që janë: "për kërkimin shkencor bazë" (1) "për veprimtaritë shkencore" (2) dhe "për botime" (3).</p>	Shuma Arkëtuar	9,000 €	5,400 €	3,600 €					Fitimi 154 €
Shuma Arkëtuar										
9,000 €										
5,400 €										
3,600 €										
Fitimi 154 €										

⁸³[Evidenca 32.c. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit & studentëve] <https://gjidhet.net> në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁴Evidenca 21. Raport vjetor i punës kërkimore 2021-2022 dhe 2022-2023 i DSHETP] <https://gjidhet.net> në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁵[Evidenca 32.d. Botimet e UniBa-s për 3-5 vitet e fundit]]gjidhet.net në: <https://ascal.al/sq>

Konkluzione	<p><i>Kërkimi shkencor në UniBa funksionon në bazë të Rregullores së mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional mbulon një pjesë të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti.</i></p> <p><i>Rekomandohet që UniBa të parashikojë rritjen e buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për mbështetjen e botimeve të artikujve me me faktor impakti".</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga bisedat e zhvilluara në Institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse për këtë program ndërmerr një rol të rëndësishëm në mbështetjen e grupeve lëndore dhe është gjithmonë në përpjekje për të realizuar projekte inovative kërkimore-shkencore. Kjo njësi koordinon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë me strukturat kërkimore të tjera brenda dhe jashtë fakultetit, duke synuar realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e studimit nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.⁸⁶</p> <p>Bordi i Karrierës është një aktor i rëndësishëm në ndihmesën që jep edhe në programet e studimit që mbulohen nga Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit profesional. Veprimtaria e bordit të karrierës realizohet në funksion të integritit të studentëve në tregun e punës. Bashkëpunimi mes Departamentit dhe Bordit konsiston në përmirësimin e kurrikulës dhe organizimin e praktikave profesionale në mënyrë që studentët të përfitojnë sa më shumë nga kërkesat e tregut të punës.⁸⁷</p>

⁸⁶Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁷[Evidenca 8. Politika e zhvillimit të stafit akademik]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Graf

[Signature]

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Siç është paraqitur edhe në RVB, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve dhe Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka organizuar projekte, konferenca,⁸⁸ si edhe fushata kombëtare/lokale në përputhje me planin strategjik të UniBa-së, ku janë angazhuar personel akademik i vetë universitetit, personel akademik i ftuar, studentë, apo edhe aktorë të tjerë të interesuar.⁸⁹ Rezulton se nuk ka pasur kërkesa prej personave të interesuar kundrejt Fakultetit të Edukimit/Departamentit të Pedagogjisë për të kryer analiza apo studime me karakter kërkimor-shkencor.</p> <p>Personeli akademik dhe ai mbështetës nxiten të kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Universiteti "Barleti" ka themeluar institutet dhe qendrat e tij si mëposhtë vijon:⁹⁰</p> <ul style="list-style-type: none"> - Instituti i Kërkim Zhvillimit "Barleti" IKZHB (BIRD); - Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike ISHÇP (AIPA); - Instituti i Edukimit "Barleti" IEB (BEI); - Instituti ADRIAPOL Kërkim, Zhvillim, Rritje, Inovacion ; - Qendra YOUTH ACT ; - Qendra Education in United States "EDUSA".
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" synon të sigurojë se studentët janë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm dhe për të përmbushur kërkesat e licencimit në fushën e tyre të specializimit.</p> <p>Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar një sërë leksionesh të hapura dhe seminare për zhvillimet e reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë. UniBa ka lidhje të ngushta me institucione dhe shkolla të ndryshme me të cilat zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor. Të ftuarit kanë qenë nga shumë fusha dhe personalitete të mirënjohur për ekspertizën apo eksperiencën e tyre.</p>

⁸⁸[Evidenca 32.a. Lista e Konferencave dhe workshopeve] :]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁰[Evidenca 21. Raport vjetor i punës kërkimore 2021-2022 dhe 2022-2023 i DSHETP]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-uniba.html
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit në "Gjuhë dhe Komunikim" synon të sigurojë se studentët janë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm dhe për të përmbushur kërkesat e licencimit në fushën e tyre të specializimit. Sipas RVB, Institucioni ka ngritur njësinë "BRIDGE" (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), që ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. ⁹¹
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Për sa i përket programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Gjuhë dhe Komunikim", njësia përgjegjëse ka një qasje të përgjegjshme dhe të përshtatshme ndaj rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale dhe rrjetet profesionale. Kjo njësi jo vetëm që i merr parasysh këto rekomandime, por gjithashtu i zbaton ato në zhvillimin e programit të studimit. Universiteti "Barleti" zhvillon aktivitete me Bordin e Karrierës, ⁹² ku diskutohet për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës. Bordi ndihmon për punësimin e studentëve të fushës së edukimit, që diplomohen dhe certifikohen në UniBa, si në institucionet publike, ashtu edhe në ato private https://umb.edu.al/neës1166.html Studentët që do të diplomohen, pas zhvillimit të praktikës profesionale që menaxhohen nga ZVA-të, do të hyjnë në provimin për licencim.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" është në përputhje me aktet ligjore vendore dhe rekomandimet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Këto përfshijnë, për shembull, "Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU" (Direktiva për Kualifikimet Profesionale, 2005/36/EU). Kjo lidhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare tregon se programi i studimit është i përshtatshëm për të përgatitur profesionistë në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht për profesionet e rregulluara. ⁹³

⁹¹[Evidenca 6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare] <https://ascal.al/sq>

⁹²[Evidenca 28. Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës, DSHEP] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹³Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" është një program bashkëkohor. Institucioni ka ngritur njësinë "BRIDGE" (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), e cila ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional përcaktohet se çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje, në mënyrat si më poshtë në: <ul style="list-style-type: none"> ○ orë leksionesh; ○ orë seminaresh; ○ orë mësimi të integruara: leksione me seminarët; ○ orë ushtrimesh; ○ orë laboratorësh; ○ projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; ○ provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; ○ formatë praktikës profesionale të zhvilluara në auditor; ○ forma të praktikës profesionale të zhvilluar në laboratorë dhe/ose institucione/kompani me të cilat Departamenti i

	<p>Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose në ente publike/private të zgjedhura nga vetë studenti dhe të dakordësuara me pedagogun përkatës të praktikës;</p> <ul style="list-style-type: none"> o çdo formë tjetër të miratuar nga njësia kryesore. <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion, por edhe në bisedat me pedagogë dhe studentë, rezultoi se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale.⁹⁴</p> <p>Sipas RVB, studentëve u rekomandohet literatura plotësuese për të zgjeruar të nxënit jashtë auditorit dhe për të rritur pavarësinë apo të menduarit kritik.⁹⁵</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, rezulton se ka një prirje të përgjithshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, duke përdorur edhe teknika të përvetësuara gjatë programeve të shkëmbimit me universitetet partnere jashtë vendit.⁹⁶</p> <p>Personeli akademik përdor metoda të larmishme, ndërvepruese që bazohen në filozofinë ‘studenti në qendër të të nxënit’ të tilla, si: diskutime, studime rasti, punë në grupe, prezantime, lojë me role, projekte, simulime etj., të cilat konsiderohen si forma kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve.⁹⁷</p> <p>Rregullorja e monitorimit të cilësisë në universitetin “Barleti” bazohet në nenin 38, pikat 1, 3 dhe 46 të ligjit nr 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit të UniBa dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit.</p> <p>Janë disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi nga Këshilli i performancës që ngrihet nga rektori;

⁹⁴[Evidenca 2.6. Programe lëndore/syllabuse]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁵Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁶Evidenca1. Rregullore e fakultetit FSHSTS]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁷Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i koordinatorit të programit përmes raportimit; - Vlerësimi i mësimdhënies në auditor që kryhet nga dekani ose përgjegjësi i departamentit lidhur me personelin akademik; - Vlerësimi i realizuar nga pedagogu i lëndës përmes analizës së pyetësorëve të studentëve; - Zhvillimi i orëve të hapura për një temë mësimore të caktuar
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre.</p> <p>NJZHCK organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët në online dhe bën të ditur për stafin akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Për çdo anëtar të departamentit ekzistojnë raporte individuale lidhur me performancën e secilit pedagog, por që trajtohen në mënyrë konfidenciale. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UniBa. Çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që iu bëhet nga studentët.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe që lidhet me performancën e stafit akademik, kryesisht nisur nga mobiliteti i personelit akademik dhe nga përmbajtja e CV-ve të personelit akademik të paraqitura, konstatohet se personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse.⁹⁸ Siç edhe përmendet në RVB, organizimi i konferencave dhe seminareve shkencore në partneritet me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit, ka krijuar mundësi që personeli akademik të shkëmbejë përvojë, mendime dhe literaturë në fushat e tyre të ekspertizës.⁹⁹</p> <p>Institucioni ka mbështetur personelin akademik të përfitojë nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet e huaja.¹⁰⁰</p> <p>Institucioni ka mbështetur pjesëmarrjen në konferenca e takime kombëtare e rajonale, përfshirjen në studime e botime, si dhe projekte të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.¹⁰¹</p>

⁹⁸[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁹[Evidenca 13.b. Shkëmbime Erasmus+]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁰[Evidenca 13.a. Linqet e veprimtarive të departamentit për trajnime dhe pedagogë të fuar]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰¹[Evidenca 21. Raporti i kërkimit shkencor të departamentit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	Sipas RVB, departamenti zhvillon vëzhgime për përmirësimin e kompetencës didaktike dhe pikave të dobëta . ¹⁰²
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	NJZHKC është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve online, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, qoftë në rrugë konfidenciale, qoftë në rrugë publike. Rezulton nga krahasimi i CV-ve ¹⁰³ të personelit akademik të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional me llojin e lëndës që zhvillon çdo PAE dhe PAK, se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo PAE/PAK e zhvillon mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë. Personeli akademik që është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi është me grada dhe tituj akademikë ¹⁰⁴ si dhe kanë përvojë të gjatë në mësimdhënie. ¹⁰⁵ Kodi i Etikës i UniBa-së i miratuar vite më parë, ka vendosur mënyra të detyrueshme sjelljeje nga personeli akademik, e parashikuar kjo në nenin 4 të kodit, si kundrejt njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt studentëve, shkelja e të cilave pas sjell pasoja për të gjitha palët e përfshira. ¹⁰⁶
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga vizitat në institucion, nga takimet me grupe të ndryshme studentësh, por edhe nga konsultimi me dokumentacionin e paraqitur në RVB, konstatohet se për vlerësimin e procesit dhe të formave e të metodave të mësimdhënies merret edhe mendimi i studentëve. Sipas RVB, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë: ¹⁰⁷
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për të plotësuar kërkesat ligjore, UniBa-ja ka miratuar Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ¹⁰⁸ e cila synon të përcaktojë funksionimin dhe

¹⁰²Evidenca 16.5. Formulari i vlerësimit koleg me koleg], [Peer Evaluation of Teaching] <https://gjendet.net>:

<https://ascal.al/sq>

¹⁰³[Evidenca 7.2. CV e Stafit Akademik 2021-2023]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁴Raporti i kërkimit shkencor të departamentit] <https://gjendet.net>: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁵[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies]:gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁶Evidenca 33 Kodi i Etikës.pdf.pdf [Evidenca 21.]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁷[Evidenca 48.1.Të dhënatabelorepërangazhiminnësig.cilësisë]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁸Evidenca 48 Plan pune NjZhKC.pdf.pdf: gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në UniBa. Kjo rregullore synon, midis të tjerash, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbytur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UniBa-së duke garantuar, gjithashtu, se mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në UniBa të jetënë përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Rregullorja ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja përcakton se në nivel fakulteti, përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); ○ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.MSc.); <p>Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.MSc.)</p> <p>Rezultatet e vlerësimit, ndryshe nga praktikat e të kaluarës nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë pedagogëve për të qenë më aktivë në planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit i shërbejnë institucionit si matës i performancës me qëllim rritjen e kapaciteteve të personelit akademik për mësimdhënien në auditor. Trajnimet e vazhdueshme, leksionet e hapura, prezantimet nga pedagogë dhe promovimi i praktikave më të mira janë forma të përdorura në UniBa për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.¹⁰⁹</p> <p>UniBa ka hartuar njëmanualudhëzuesnë nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme bashkëkohore të mësimdhënies.¹¹⁰</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se personeli akademik, i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Gjuhë dhe Komunikim", bën përpjekje të vazhdueshme për</i></p>

¹⁰⁹[Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa-s]] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁰[Evidenca 16.4. Formular ivlerësimit të lëndës dhe pedagogut ngastudentët] <https://ascal.al/sq>

	<p><i>rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Personeli akademik përdor forma të larmishme të mësimdhënies, të të nxënit, si edhe të transmetimit të dijeve. Këto forma i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga një personel akademik që zhvillon ato lëndë mësimore që janë në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre. UniBa është në bashkëpunim të përhershëm me përvojën e lektorëve të huaj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Universiteti shihet të ketë një përvojë të larmishme në format e mësimdhënies dhe nxënies. Leksionet, seminarët, orët e hapura, projektet, detyrat e kursit dhe esetë, praktikat profesionale mbizotërojnë në procesin mësimor.</p> <p>Kontrolli i dijeve i realizuar në mënyrë të vazhdueshme identifikon pikat e forta dhe të dobëta të transmetimit të dijeve. Në këtë program studimi që i referohet pikërisht çështjes së mësimdhënies dhe nxënies evidentohet edhe nga studentët në takimet që patëm me ta se ata kanë mësuar shumë gjëra të vlefshme për profesionin e tyre dhe që lidhen me eliminimin e rutinës ditore siç është zhvillimi i orës mësimore me të njëjtin format, në çdo lëndë dhe temë mësimore, duke i bërë ata të jenë krijues dhe motivues me larmishmërinë që sjellin në klasë.</p> <p>Detyrat e kursit, esetë dhe projektet që studentët prezantojnë lidhen me temat që shqetësojnë arsimin në tërësi dhe cikle shkollimi apo lëndë në veçanti. Po ashtu shihet të jenë përdorur formate të ndryshme trajnimi që lidhen me kërkesat në rritje të tregut të punës.</p> <p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, sidhe e aftësive profesionale të studentëve, paraqiten dhe promovohen në dokumentet rregullatorë të mëposhtme:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;¹¹¹ ○ Rregulloren e Programit të Studimit.¹¹² <p>Në rregulloren e programit të studimit, kreu III, neni 23 theksohet se : Vlerësimi¹¹³realizohet në forma të ndryshme që lidhen me vlerësimin formues/i vazhduar dhe atë përfundimtar. Vlerësimi në një lëndë realizohet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) pjesëmarrje/frekuentim; b) provim të ndërmjetëm; c) detyrë kursi; d) provim përfundimtar. <p>Kalimi nga njëri sistem vlerësimi te tjetri bëhet në përputhje me kërkesat e dokumenteve që vijojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) rregullorja akademike, b) rregullorja e programit, c) programi lëndor (syllabus). <p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale tregohet në çdo program lëndor dhe bëhet i njohur nga pedagogu që zhvillon lëndën prej prezantimit të parë me pedagogun.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga intervistat e zhvilluara me pedagogët dhe studentët, por edhe nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se në të gjitha programet lëndore¹¹⁴ (syllabuset)¹¹⁵, në një rubrikë të veçantë tregohet edhe forma e kontrollit të dijeve, vlerësimi i frekuentimit, si edhe mënyra e realizimit të kontrollit të vazhdueshëm, bashkë me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.¹¹⁶</p> <p>Në këtë rubrikë jepen edhe mënyra e përllogaritjes së vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Menjëherë pas prezantimit të lëndës prej pedagogut në fillim të vitit akademik, studentëve u bëhet e njohur edhe metodologjia e</p>

¹¹¹[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK] :]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹²[Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa-s]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹³[Evidenca 13. Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁴[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁵[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)] [https://](https://ascal.al/sq)gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁶[Evidenca 44. Procedura për monitorimin e fillimit të procesit mësimor] [https://](https://ascal.al/sq)gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Q. Stafa

[Signature]

	plotë dhe e detajuar e mënyrës së vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Mënyrat e ndryshme të testimit dhe të vlerësimit të njohurive tregohen në Rregulloren e Programit të Studimit,¹¹⁷ ku përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar; ○ Me detyra kursi ose projekte; ○ Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime. <p>Në format e vlerësimit të vazhduar përfshihen: vlerësim për përgjigjet në seminare, aktivizimi, provim me shkrim, me detyra kursi, projekte, ese. Vlerësimi përmbledhës realizohet me test përmbledhës në fund të vitit akademik.</p> <p>Përveç mënyrës së treguar në mënyrë të përgjithshme të rregullores për vlerësimin e dijeve dhe njohurive, çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit dhe miratimit të programeve lëndore përcakton edhe mënyrën konkrete të vlerësimit për çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.¹¹⁸</p>			
Konkluzione	<p><i>Gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", për vlerësimin e studentëve, përdoren kritere të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹⁷[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁸[Evidenca 1.2. Rregullore e Uniba-s]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në UniBa, siç është treguar edhe më sipër në këtë RVJ gjatë analizës së kriterëve të mëparshme, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, si edhe e aftësive profesionale të studentëve parashikohen kryesisht në Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (Vlerësimi i studentëve).¹¹⁹</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i provimit të ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë/tetë të semestrit; • Realizimi i provimit përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë/gjashtëmbëdhjetë të semestrit dhe që përmban 50% të vlerësimit përfundimtar; • Detyrat/projektet/estetë/aktivizimi të cilat zhvillohen apo vlerësohen gjatë gjithë semestrit dhe që përmbajnë 10% të vlerësimit përfundimtar. <p>Çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit, miratimit, si edhe zbatimit të programeve lëndore, përcakton edhe mënyra të tjera specifike të vlerësimit për çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.</p> <p>Në vlerësimin e dijes së studentit pedagogu mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm, si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, ushtrime, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi.¹²⁰ Pra, vlerësimi përfundimtar i njohurive është bashkimi i vlerësimit të vazhdueshëm me vlerësimin përmbledhës që realizohet me anë të testit në fund të realizimit të programit mësimor të lëndës.¹²¹</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Personeli akademik me kualifikimet që disponon është i aftë të tregojë lidhjen që ka me procesin mësimor që zhvillohet në ciklet e ndryshme të arsimit parauniversitar dhe si pasojë e përvojës së pasur që ka të lidhë nevojat e studentëve me zhvillimet teorike që realizohen në auditor. Edhe detyrat e përzgjedhura flasin për oferta alternative që i bëjnë studentët të zhvillojnë projekte, të</p>

¹¹⁹[Evidenca 3. Rregullore e programit tëstudimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁰[Evidenca 2.6.a. Tezë e provimit të ndërmjetëm. Tezë e provimit përfundimtar. Model raport vlerësimi të studentit] <https://ascal.al/sq>

¹²¹[Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa-s]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>realizojnë studime rasti, të kërkojnë dhe të prezantojnë detyra komplekse ku ndërlihet mendimi kritik dhe reflektiv me veprimtarinë e përditshme mësimore. Përdorimi i teknologjisë së informacionit e ka bërë më aktiv pozicionin e studentit që përpiqet të sjellë forma alternative prezantimi të detyrave të tij.</p> <p>UniBa, krahas vlerësimit “paper based test” dhe vlerësimit me gojë, zbaton edhe vlerësimin elektronik ¹²², që nënkupton hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës/projektit të kursit.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Rezulton se mënyra e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve, gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në Mësuesi “Gjuhë dhe Komunikim”, por edhe vlerësimi përfundimtar i studentëve, bëhet siç është përcaktuar në çdo program lëndordhe që është bërë publike përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën dhe që kanë marrë pjesë në provim. Hartimi i testit përmbledhës miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Fleta e vlerësimit firmoset nga dekani dhe kryesekretari.</p> <p>Pedagogu i modulit/ lëndës duhet t’i ketë në evidencat e tij të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj.). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar. ¹²³</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si edhe nga takimet me personelin akademik të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe me studentë që ndjekin programin e studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në Mësuesi “Gjuhë dhe Komunikim”, u konstatua se pedagogët e lëndëve që përfshihen në zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Gjuhë dhe Komunikim”, në mënyrë të vazhduar përgjatë gjithë vitit shkollor, u japin komente studentëve, me shkrim ose me gojë, për çdo etapë të vlerësimit të vazhduar (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, projekt, ese), me qëllim përmirësimin e performancës së studentëve në të ardhmen. ¹²⁴</p>

¹²²Evidenca 29.a.Manual i mësimdhënies online UB_2020-2021]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²³[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁴[Evidenca 2.6.a. Tezë e provimit të ndërmjetëm. Tezë e provimit përfundimtar. Model raport vlerësimi të studentit]:]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Përcaktimi i nocionit të plagjiaturës, mënyrat e shmangies së saj, si edhe penaltetet që jepen për çdo rast konstatimi të plagjiaturës, jepen në nenet e Kodit të Etikës të UniBa-së. Gjithashtu, po në këto nene është përcaktuar detyrimi i institucionit për të siguruar programe softuerike që kontrollojnë në mënyrë automatike për plagjiaturë të mundshme në detyrat e kursit, projektet, si edhe esetë e paraqitura për marrjen e diplomave "Bachelor", apo "Master".</p> <p>Rregullorja e UniBa parashikon mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen prej pedagogëve të lëndëve konkrete, për të shmangur kopjimin prej studentëve gjatë zhvillimit të provimeve në lëndët që përfshihen në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në " Gjuhë dhe Komunikim".</p> <p>Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga departamenti.¹²⁵ Ndaj studentit që kryen kopjim merren masa disiplinore sipas rastit: vërejtje me shkrim, përjashtim për një vit nga UniBa, përjashtim përgjithmonë nga UniBa.¹²⁶</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në analizën e kriterëve të mëparshme në këtë RVJ, mënyra e zhvillimit të provimit përcaktohet nga Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve. Ndërsa në rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional tregohet procedura që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e procedurave të ndjekura, apo edhe për ankimimin e rezultateve të provimeve.¹²⁷</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas RVB Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jo zyrtare, para se t'i hedhë ato në regjistër, duke i dhënë mundësi studentëve të sqarohen lidhur me notat e vendosura. Studenti ka të drejtë të ankohet nëse mendon se korrigjimi nuk është korrekt dhe të diskutojë vlerësimin e punës së tij me Pedagogun e lëndës. Më pas, në rast mosrënie dakord atij i hapet rruga për bërjen e ankimit sipas shkallëve të treguara në rregullore.</p>

¹²⁵[Evidenca 1.2. Rregullore UniBa] <https://ascal.al/sq>

¹²⁶[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]][gjendet në: https://ascal.al/sq](https://ascal.al/sq)

¹²⁷[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]][gjendet në: https://ascal.al/sq](https://ascal.al/sq)

	Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet. ¹²⁸		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas Rregullores së Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, tregohen edhe procedurat që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e procedurave të ndjekura apo për ankimimin e rezultateve të provimeve. Ankesa e studentit i drejtohet me shkrim drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia delegon ankimin tek drejtuesi i njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë i paraqet drejtuesit të njësisë kryesore një relacion shpjegues dhe më pas, drejtuesi i njësisë kryesore vendos miratimin apo refuzimin e ankimit të studentit. ¹²⁹ Nëse ankimi i studentit miratohet, drejtuesi i njësisë kryesore ngrë një komision ad-hoc, i cili ndjek një procedurë të përcaktuar qartë për të ndryshuar apo jo vlerësimin fillestar të studentit. Procedura që ndiqet për raste të tilla, arkivohet sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren për Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UniBa.		
Konkluzione	<i>Rezulton se në UniBa, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përmes formave të larmishme. Provimi përfundimtar zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu, studentët kanë të drejtën e njohjes me vlerësimin dhe të drejtën e ankimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

¹²⁸[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁹[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional¹³⁰ (120 kredite) në Mësuesi në “Gjuhë dhe komunikim” me dy vite akademike, në objektivat e programit, thekson se programi synon një kualifikim teorik dhe praktik të studentëve krahasuar me nivelin e ciklit të parë, si edhe synon të japë kontribut për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ngritjes së standardeve të mësuesit duke bashkëpunuar dhe ndihmuar shkollat që ushtrojnë veprimtari në këtë hallkë të arsimit të nxënësve. Programi mundëson, gjithashtu, studime të thelluara në mësimdhënie, në procesin e të nxënësve, si edhe në fushën e arsimit të të rriturve.</p> <p>Universiteti shihet të ketë një përvojë të larmishme në format e mësimdhënies dhe nxënies. Leksionet, seminarët, orët e hapura, projektet, detyrat e kursit dhe esetë, praktikat profesionale mbizotërojnë në procesin mësimor.</p> <p>Kontrolli i dijeve i realizuar në mënyrë të vazhdueshme identifikon pikat e forta dhe të dobëta të transmetimit të dijeve. Në këtë program studimi që i referohet pikërisht çështjes së gjuhës dhe komunikimit evidentohet edhe nga studentët në takimet që patëm me ta se ata kanë mësuar shumë gjëra të vlefshme për profesionin e tyre dhe që lidhen me eliminimin e rutinës ditore siç është zhvillimi i orës mësimore me të njëjtin format, në çdo lëndë dhe temë mësimore, duke i bërë ata të jenë krijues dhe motivues me larmishmërinë që sjellin në klasë.</p> <p>Detyrat e kursit, esetë dhe projektet që studentët prezantojnë lidhen me temat që shqetësojnë arsimin në tërësi dhe cikle shkollimi apo lëndë në veçanti. Po ashtu shihet të jenë përdorur formate të ndryshme trajnimi që lidhen me kërkesat në rritje të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Personeli akademik me kualifikimet që disponon është i aftë të tregojë lidhjen që ka me procesin mësimor që zhvillohet në ciklet e ndryshme të arsimit parauniversitar dhe si pasojë e përvojës së pasur që ka të lidhë nevojat e studentëve me zhvillimet teorike që realizohen në auditor. Edhe detyrat e përzgjedhura flasin për oferta alternative që bëjnë studentët: të zhvillojnë projekte, të realizojnë studime rasti, të kërkojnë dhe të prezantojnë detyra komplekse ku ndërlihet mendimi kritik dhe reflektiv me veprimtarinë e përditshme mësimore. Përdorimi i teknologjisë së informacionit e</p>

¹³⁰[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>ka bërë më aktiv pozicionin e studentit që përpiqet të sjellë forma alternative prezantimi të detyrave të tij.</p> <p>Zbatimi i Planit Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", përmes zhvillimit të lëndëve specifike, parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit përmes zhvillimit të lëndës Teknologjitë në Edukim.¹³¹ ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën pedagogjike dhe psikologjike, përmes zhvillimit të lëndëve të tilla si Psikologji Edukimi, Metodat e Kërkimit Shkencor, Teoritë e të Nxënit dhe Modelet e mësimdhënies, Menaxhimi i klasës, Vlerësimi i të nxënit, Zhvillim kurrikule dhe mendim kritik, Kompetencat kyçe evropiane, etj. ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe gjuhësisë përmes zhvillimit të lëndëve të tilla si Kurrikula e gjuhës shqipe, Kurrikula e letërsisë, Didaktikat përkatëse, Kurrikula e aftësive të komunikimit, Aftësim praktik në gjuhë, letërsi dhe komunikim.¹³² <p>Sipas bisedave me stafin akademik dhe RVB-së, ky program studimi është zhvilluar nëpërmjet një procesi mësimor (mësimdhënie dhe të nxënë) ballëpërballë në auditor. Procesi i mësimdhënies bazohet fort tek metodat që kanë në qendër studentin dhe ndërveprimin aktiv pedagogjik. Mësimdhënia shoqërohet me video-projektor, mjediset kanë internet dhe pedagogët kanë lehtësitë e duhura për kombinimin e mësimdhënies me pajisjet TIK.</p> <p>UniBa ka disa manuale dhe guida për mësimdhënien online, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Manual i mësimdhënies online, 2) Manual për përdorimin e Google classroom (për pedagogët dhe studentët),¹³³ 3) Manuali i përdorimit të GSuit,¹³⁴
--	---

¹³¹[Evidenca 29.a. Manual mësimdhënies online UB_2020-2021]<https://ascal.al/sq>

¹³²[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)][gjendet në: https://ascal.al/sq](https://ascal.al/sq)

¹³³[Evidenca 38.b. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët][gjendet në: https://ascal.al/sq](https://ascal.al/sq)

¹³⁴Evidenca 38.c. Manuali i përdorimit të GSuit][gjendet në: https://ascal.al/sq](https://ascal.al/sq)

	<p>4)Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit,¹³⁵</p> <p>5) Guidë instruktive e mësimit online¹³⁶, në mënyrë që procesi i mësimit online të zhvillohej sa më lehtë dhe në mënyrë eficiente.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Institucioni mbështet kualifikimin e punonjësve të vet si brenda institucionit, ashtu edhe më gjerë. CV e stafit akademik janë të pasura me trajnime dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përmirësimi i kompetencave didaktike shihet të jetë fokusi i trajnimeve që organizon vetë departamenti dhe projekteve trajnuese me shkallë të gjerë siç është ai i përgatitjes së drejtuesve të shkollave.</p> <p>Institucioni ka mbështetur takime dhe konferenca rajonale, si dhe pjesëmarrjen e lektorëve të tij në aktivitete shkencore si konferenca, simpoziume, etj jashtë vendit.</p> <p>Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, qysh prej prezantimit të lëndës prej pedagogut në orën e parë mësimore, studentët janë të qartë për kompetencat dhe aftësitë që ata duhet të fitojnë dhe zotërojnë. Gjithashtu, në përfundim të programit të çdo lënde, studentët vlerësohen përmes një metode të kombinuar: përmes provimit të ndërmjetëm, përmes provimit përfundimtar, si edhe përmes pjesëmarrjes në detyra kursi, ese, prezantime etj.¹³⁷</p> <p>Në analizën e departamentit apo edhe të UniBa-s¹³⁸ shqyrtohet gjerësisht niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të</p>	<p>Nga rezultatet e pyetësorëve del se stafi akademik zotëron kompetencat e duhura në mësimdhënie dhe vlerësim të nxënies së studentëve. Matja e rezultateve në mënyrë periodike ndihmon stafin në zhvillimin e një plani strategjik të programit të studimit, duke qenë konkret, me objektiva të mirëpërcaktuar si për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, ashtu dhe për përdorimin e metodave efikase të mësimdhënies.</p> <p>Në këtë aspekt, përmes dokumentacionit të prezantuar nga institucioni shihet një interesim i vazhdueshëm i strukturave drejtuese në nivel institucioni, fakulteti, përgjegjësi departamenti dhe pedagogu për mendimet dhe opinionet e studentëve në lidhje</p>

¹³⁵[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit]]gjendet në:

<https://ascal.al/sq>

¹³⁶[Evidenca 38. Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁷[Evidenca 16.8. Raportimbirezultatet e formularitëstudentit 21-22, sem. II]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁸[Evidenca 60.5. Raporti Vjetor i Departamentit 2021-2022] & [Evidenca 60.6. Raporti Vjetor i Departamentit 2022-2023]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>me programin e studimit. Takime, pyetësorë, trajnime , konferenca janë format që përdoren për të tërhequr mendimet e tyre, vërejtjet dhe analizat që ata bëjnë në mënyrë të vazhdueshme</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion zhvilloi dhe bisedat me studentët e programit të studimit, ku u konstatua se mësimdhënia që zhvillohet në këtë departament, bazohet në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe qëndrimeve të studentëve, duke u ofruar atyre mundësi për zhvillimin e njohurive që lidhen si me përgatitjen e tyre shkencore, ashtu dhe me përgatitjen pedagogjike.¹³⁹</p> <p><i>Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për këtë qëllim, realizohen diskutime të stafit për ndarjen e përvojave më të mira dhe për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të fituara përmes mobilitetit të stafit në universitete të tjera evropiane, pjesë e programit Erasmus+. Kjo përfshin sesione bashkëbisedimesh, ku personeli akademik ndan me njëri-tjetrin me praktikatat më të suksesshme dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre të huaja. Ky proces i shkëmbimit të njohurive shërben për të pasuruar ambientin akademik dhe për të siguruar një perspektivë ndërkombëtare në zhvillimin e veprimtarive të universitetit.</p> <p>Literatura dhe shembujt e dhënë nga praktika e përditshme mësimore në cikle të ndryshme shkollore e motivojnë studentin të jetë aktiv dhe kritik në diskutimet dhe detyrat e tij, duke i dhënë kështu edhe pedagogëve rast për të reflektuar dhe përmirësuar më tej punën e tyre.¹⁴⁰</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni përdor forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies për të qenë sa më tërheqës dhe interesant për studentët. Metodatat interaktive si biseda, debate për çështje të ndryshme arsimore, studim rasti, shikim videosh profesionale me tematikë orët e mësimit, etj janë karakteristikë e mësimdhënies në këtë program studimi.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional është një ambient ku stimulohet dhe promovohet bashkëpunimi mes departamenteve në realizimin e projekteve inovative. Në këtë kontekst, institucioni aktivisht inkurajon dhe mbështet</p>

¹³⁹[Evidenca 10. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁰[Evidenca 13.a. Linqet e veprimtarive të departamentit për trajnime dhe pedagogë të ftuar]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>financiarisht projektet që dalin nga bashkëpunimi midis departamenteve, duke e parë këtë si një mjet të rëndësishëm për të nxitur ide inovative dhe për të përparuar studimet kërkimore nga ana e studentëve. Projektet që lidhen me shkëmbimin e ideve dhe resurseve midis departamenteve shërbejnë si një mjet për të thelluar bashkëpunimin në fusha të ndryshme të zhvillimit të dijes. Përveç kësaj, konferencat studentore ofrojnë një platformë ku studentët mund të paraqesin punën e tyre, duke ndarë idetë e tyre me një audiencë të gjerë dhe duke kontribuar kështu në krijimin e një mjedisi të pasur intelektual dhe kulturor në Fakultet. Përmes mbështetjes financiare, institucioni shfaq përkushtim ndaj zhvillimit të njohurive dhe idesë inovative të studentëve, krijuan një mjedis të stimulueshëm për rritjen e dijes dhe krijimin e një komuniteti akademik të pasur dhe të përfshirë.</p>			
Konkluzione	<p><i>Zbatimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Mësuesi Gjuhë dhe komunikim", parashikon zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme me natyrë teknologjike/ pedagogjike/ gjuhësore /komunikuese. Këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndëve të ndryshme dhe programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe komunikim"¹⁴¹ përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ modalitetet që ndiqen për të zgjedhur midis punimit të diplomës apo provimit përfundimtar; ○ modalitetet për t'u regjistruar për provim diplome; ○ përgatitja dhe vlerësimi i tezës së diplomës; ○ mbrojtja e tezës së diplomës;

¹⁴¹[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<ul style="list-style-type: none"> ○ organizimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës; ○ mënyra e pajisjes me diplomën përkatëse, pasi studenti përmbush të gjitha detyrimet akademike.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Siç edhe përmendet edhe në RVB, kërkesat e çdo studenti që shprehin vullnetin e tyre për të zgjedhur midis zhvillimit të provimit të formimit apo mbrojtjes së temës së diplomës shqyrtohen në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional nga ku dalin edhe listat përfundimtare. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, nëpërmjet personelit akademik efektiv, organizon seanca orientuese, me qëllim sqarimin dhe udhëzimin e studentëve që do të zhvillojnë provimin e formimit, duke u mbështetur në fondin e përgjithshëm të pyetjeve, të vendosura në departamentin e pedagogjisë. Studentët të cilët do të mbrojnë temë diplome kanë të drejtë që të përcaktojnë vetë temën që do të trajtojnë në punimin e diplomës. Rregulla më të hollësishme për të gjithë procesin e përmendur më sipër jepen në Manualin e posaçëm për punimin e temës së diplomës.¹⁴²</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit përcaktohet mënyra e ngritjes së komisionit të provimit, llogaritja e notës përfundimtare të studentit, lëndët që do të përfshihen në provim, si edhe formati i tezës së provimit përfundimtar. Për të fituar diplomën e studimeve master, studentët që ndjekin programet Master Profesional, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale (mbrojtje e temës së diplomës).¹⁴³ Komisioni i Provës Finale i ngritur për vlerësimin e studentëve në provimin final të programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" bazohet në procedurat e përshkruara hollësisht të paketës së provimit të formimit.¹⁴⁴</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional (120 ETC) në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" i nënshtrohen provimit të formimit.¹⁴⁵ Në rastet kur kemi tezë diplome (tezë kërkimi bëjnë</p>

¹⁴²[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMGJK] :]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴³[Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁴[Evidenca 2.5. Tezat e Provimit te formimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁵[Evidenca 2.5. Tezat e Provimit te formimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbysllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>ata studentë që kanë mesatare mbi 9,5) me vendim senati këtyre studentëve u caktohet udhëheqësi nga stafi i departamentit dhe miratohet komisioni i diplomimit për mbrojtjen e tezës.¹⁴⁶</p> <p>Sipas udhëzuesit, udhëheqësi i diplomës duhet japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve, si edhe përgatitjen e punimit. Gjithashtu, udhëheqësi i diplomës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ vlerëson rregullisht progresin e studentit kryesisht përmes raporteve të shkruara nga vetë studenti; ○ monitoron punën e studentit përkundrejt standardeve të kërkuara. <p>Në fund të procesit, udhëheqësi i diplomës konfirmon se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga konsultimet me dokumentacionin që lidhet me infrastrukturën fizike të UniBa-së, siç përmendet edhe në RVB, por edhe nga takimet e realizuara me studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", u konstatua se ambientet e UniBa-së janë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për të punuar për përgatitjen në provimin final të formimit¹⁴⁷ apo temës së diplomës: në veçanti mund të përmenden ambientet e bibliotekës¹⁴⁸ dhe të laboratorit të teknologjisë. Këto mjedise mund të përdoren nga studentët diplomantë si për përgatitjen e përgjithshme të temës së diplomës, ashtu edhe për hedhjen e të dhënave tabelore, grafike dhe të bërjes së analizave statistikore, në varësi të specifikave të temës së zgjedhur.</p> <p>Tezë kërkimi bëjnë ata studentë që kanë mesatare mbi 9,5 me vendim senati. Studentët e tjerë e kanë me provim formimi provën finale.¹⁴⁹</p>

¹⁴⁶Evidenca 2.6 Model, Teza e provimit perfundimtar.pdf.pdf]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁷[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁸Evidenca 60.7. Infrastruktura akademike në funksion të programit të MPMGJK.pdf.pdf]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁹[Evidenca 2.5. Tezat e Provimit te formimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Siç e parashikon edhe Rregullorja e Programit të studimit,¹⁵⁰⁾ studenti i programit mësimor të MP në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” (120 ETC) në provimin final të diplomës vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pas përfundimit me sukses të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" dhe pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare ndaj universitetit, studenti pajiset me Diplomën dhe Suplementin e saj,¹⁵¹ të miratuara në QSHA. Nëse studenti e kërkon, atij i vendoset në dispozicion edhe një kopje e plotë e programit mësimor të zhvilluar përgjatë dy viteve.¹⁵²</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UniBa-ja e përpunon informacionin e krijuar gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe administrative sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Rregulloren për Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UniBa.</p> <p>Çdo student i veçantë, mbi bazën e kërkesës së tij, mund të kërkojë në çdo kohë informacione që lidhen me jetën e tij akademike, brenda kufijve të caktuara në aktet rregullatore të universitetit, si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Në arkivin e UniBa-s ruhet për një periudhë të pacaktuar në sekretari një kopje e dokumentacionit të secilit student.¹⁵³</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përfundim të studimeve, për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim", parashikohen dy mënyra alternative për vlerësimin përfundimtar të studentëve: Temë diplome ose Provim përfundimtar. Parashikohen rregulla shumë të qarta për mënyrën e përgatitjes, zhvillimit, si edhe të vlerësimit të këtyre dy mënyrave. Pas dhënies së provimit të përgjithshëm përfundimtar ose zhvillimit të</i></p>

¹⁵⁰Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵¹[Evidenca 14. Suplementi i Diplomës - Master Profesional -MPMGJK] që pritet të miratohet në QSHA pas akreditimit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵²[Evidenca 14.a. Forma e diplomës 26,27,28, datë 4.3.2022]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵³Evidenca 34 Rregullore e Protokollit dhe Arkives.pdf.pdf]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<i>mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me Diplomë dhe Supplementin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga vizitat në institucion, por edhe nga bisedat me personel akademik dhe me studentë që frekuentojnë Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", rezultoi se praktikat profesionale të këtij programi realizohen nëpër institucionet arsimore të arsimit parauniversitar të arsimit 9-vjeçar në qytete të ndryshme, bazuar në marrëveshjet që ka nënshkruar institucioni, ose praktikat profesionale ¹⁵⁴ mund të kryhen edhe në shkollat pranë vendbanimit të studentëve. Në kuadër të zhvillimit të praktikës profesionale, ¹⁵⁵ departamenti bashkëpunon me partnerët e jashtëm me të cilët ka marrëveshje partneriteti, pjesë e “Barleti Partners Group” ¹⁵⁶ me të cilët realizon leksione të hapura me studentët për orientimin në tregun e punës dhe zhvillimin e praktikës profesionale.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të	Për vetë specifikën e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim", siç u theksua edhe në analizën e kriterit të mësipërm 1, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve dhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional mundëson vetëm praktika profesionale ¹⁵⁷ pranë mjediseve të institucioneve arsimore parauniversitare.

¹⁵⁴[Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e praktikës]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁵[Evidenca 13.a. Linqet e veprimtarive të departamentit për trajnime dhe pedagogë të ftuar]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁶[Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁵⁷[Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e praktikës]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

njohurive dhe kompetencave profesionale.	Për këtë program studimi, nuk praktikohen praktika klinike apo stazhe me format të teknologjisë më të fundit. Studentëve të Masterit Profesional në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim” (120 ETC) u mundësohet kryerja e praktikës në institucionet arsimore publike dhe jopublike, ¹⁵⁸ si shkolla 9-vjeçare, shkolla të arsimit të mesëm të lartë, me të cilat UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, nisur nga plani mësimor i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", praktika profesionale vlerësohet me 12 kredite dhe zhvillohet bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> ○ Manualin e praktikës profesionale; ○ Rregullore e praktikës profesionale. Praktikat u nënshtrohen të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, njëjloj si për të gjitha detyrimet e tjera. Ecuria e studentit gjatë zhvillimit të praktikës profesionale ndiqet nga mbikëqyrësi i universitetit (Pedagogu udhëheqës) dhe nga mësuesi bashkëpunues. Gjithashtu, edhe vlerësimi i studentit për praktikën profesionale bëhet përmes vlerësimit të pedagogut udhëheqës dhe mësuesit bashkëpunues, por vlerësimin përfundimtar me notë e bën pedagogu udhëheqës.			
Konkluzione	<i>Rezultojnë se praktikrat profesionale, për studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", zhvillohen në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar të qyteteve të ndryshëm ose edhe në shkollat pranë vendbanimit të studentëve. Praktika profesionale vlerësohet me 12 kredite dhe vlerësimin përfundimtar e bën pedagogu udhëheqës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁵⁸Evidenca 22.Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]]gjendet në:
<https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tcl:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																						
Kriteret	Vlerësimi																																					
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmësakademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij program studimi, në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, për zhvillimin e <i>programit të studimit Maste Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim"</i> janë 6 pedagogë me kohë të plotë dhe 1 pedagog me kohë të pjesshme. Personeli i punësuar me kohë të plotë përbën 87.5% të personelit akademik të angazhuar, konkretisht:</p> <table border="1" data-bbox="724 1182 1337 1630"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>6</td> <td>0</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>a) Personel akademik me kohë të plotë që japin mësim në këtë program janë 6, nga këta 2 janë personel akademik me titullin Prof.As.Dr, 3 me gradën "Doktor" dhe një me gradën PhD.</p>				Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAK	PAE	Prof.Dr.	-	-	-	-	Prof. As.Dr	2	-	2	-	Dr./PhD.	4	-	4	1	Msc.	-	-	-	-	Totali	6	0	6	1
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024																																			
	PAE	PAK	PAK	PAE																																		
Prof.Dr.	-	-	-	-																																		
Prof. As.Dr	2	-	2	-																																		
Dr./PhD.	4	-	4	1																																		
Msc.	-	-	-	-																																		
Totali	6	0	6	1																																		

	<p>b) Personel akademik me kohë të pjesshme është 1 me gradën "Doktor"¹⁵⁹. (2023-2024)</p> <p>Rezulton se njësia bazë që është përgjegjëse për administrimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" plotëson kërkesat e vendosura në Vendimin e MAS nr.418, datë 10.5.2017,Raporti personel akademik efektiv /studentë në nivel njësie kryesore është në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.¹⁶⁰</p>															
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit <i>Master Profesional (120 ECTS)</i> në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" janë angazhuar 1 staf akademik me Msc,në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".</p> <table border="1" data-bbox="624 987 1369 1301"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>431</td> <td>431</td> <td>0</td> <td>100%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>701</td> <td>641</td> <td>60</td> <td>91,5% / 8.5%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për programin e studimit <i>Master Profesional (120 ECTS)</i> në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim" ngarkesa e orëve të Stafit Akademik¹⁶¹ PAE gjatë periudhës 2022 – 2023, është 431 orë, kurse për vitin Akademik 2023-2024 stafi PAE mbulon 641 orë, ose dhe stafi PAK mbulon 60 orë.</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	431	431	0	100%	2023-2024	701	641	60	91,5% / 8.5%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2022-2023	431	431	0	100%												
2023-2024	701	641	60	91,5% / 8.5%												
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit</p>	<p>Bazuar në takimin me Drejtorinë e burimeve njerëzore konstatuam se, të gjithë anëtarët e personelit akademik, të punësuar në kohë të plotë dhe në kohë të pjesshme, kanë</p>															

¹⁵⁹[Evidenca 7.2. CV e Stafit Akademik 2021-2023] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁰[Evidenca 23. Të dhëna tabelore për 3 vitet e fundit të personelit akademik MPMGJK, Tabela 1 & 2, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

[Evidenca 23.1. Të dhëna tabelore për lëndët me ngarkesën, tabela 12 MPMGJK]; gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶¹Ngarkesatotale e personelit akademik të programit (Evidenca 23.1, Tabela 12, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Beut

fr

<p>akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>kontrata pune¹⁶² në përputhje me kodin e punës, duke përfshirë të gjitha kërkesat kontraktuale si aspektet financiare, sigurimet shoqërore dhe të gjitha komponentët e tjera të kontratës. Po ashtu, për rekrutimin e personelit¹⁶³, institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike, të cilat janë pjesë e akteve të brendshme rregullatore, të cilat bëhen publike dhe mund të aksesohen nga personat e interesuar në faqen zyrtare të UniBa-s.¹⁶⁴</p> <p>https://umb.edu.al/news5146.html</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Statutin e institucionit UniBa (neni 51;53;54) dhe rregulloren e IAL-së (neni 55) si dhe dokumentacionit që disponon Departamenti rezulton se janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij më kohë të pjesshme.</p> <p>Bazuar në këto dokumenta Departamenti mund të vendosë kritere specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë, kritere që miratohen më pas nga Rektori.</p> <p>Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore, duke filluar nga përcaktimi i kritereve të përgjithshme dhe specifike, shpallja ne APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në raport flitet për mjedise bashkëkohore që ka institucioni dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit për të siguruar një mësimdhënie sa më cilësore.</p>

¹⁶³[Evidenca 36. Të dhëna nga faqja zyrtare web e UniBa. Shpallja e vendeve të lira] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁴[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Në takimin me drejtues të Departamentit si dhe Degën e Burimeve njerëzore bazuar në verifikimin e dosjeve të personelit akademik dhe jo akademik konfirmojmë që ekziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, titujt dhe gradat shkencore që kanë ngarkesë mësimore në kuadrin e këtij programi, kualifikimin, punën shkencore të tyre.¹⁶⁵</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit rezulton se ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucione dhe organizatash për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Njësia kryesore e Fakultetit përgjegjëse e programit të studimit Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka edhe një paketë të praktikës profesionale ku pasqyrohet qellimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve. Në rregulloren e studimit të Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (neni 98;99;100,) si dhe në paketën e mbrojtjes finale janë të përcaktuara qartë detyrat e strukturave dhe personelit akademik lidhur me detyrimet mbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi.¹⁶⁶</p>

¹⁶⁵ [Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore][Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁶ [Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e praktikës] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit ka edhe një paketë të praktikës profesionale ku pasqyrohet qëllimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve, përgjegjësitë e personelit lidhur me realizimin dhe vlerësimin e studentëve¹⁶⁷. Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimet fizike, konstatuam se, në fillim të semestrit, studenti, në bashkëpunim me pedagogun e praktikës, përcaktuar me vendim departamenti, përzgjedh institucionin në të cilin do të zhvillojë praktikën, përcaktojnë objektivat për t'u përmbushur gjatë gjithë periudhës së praktikës. Objektivat e përcaktuara shkruhen në aneksin e marrëveshjes me institucionin pritës. Në aneks përshkruhen gjithashtu, përshkrimi i punës, përgjegjësitë dhe detyrimet e studentit.</p> <p>Pedagogu i praktikës do të takojë studentin dhe përfaqësuesin e praktikës katër herë gjatë periudhës së praktikës. Studenti, nga ana e tij, mund të kërkojë takime të tjera veç atyre të parashikuara me pedagogun kur ai ka ndonjë problem ose nevojë për ndihmë. Në fund të praktikës studentin dorëzon raportin e praktikës. Vlerësimi është procedura që kryhet pas praktikës sipas evidencës 2.3 dhe përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportin e praktikës realizuar nga studenti. 2. Vlerësimin sipas formatit standard nga mbikëqyrësi i institucionit pritës që dorëzohet në UniBa deri dy javë pas përfundimit të praktikës. <p>Vlerësimi i pedagogut të praktikës.¹⁶⁸</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mendon se Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit dhe në veçanti Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

¹⁶⁷[Evenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶⁸[Evidenca 2.3. UniBa, Paketa e praktikës] gjendet në: <https://ascal.al/sq>




				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, por edhe nga dokumentacioni shoqërues i RVB-së, u konstatua se nisur nga infrastruktura fizike¹⁶⁹, Institucioni zotëron të gjitha kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies, trajnimeve dhe çdo nevojë apo kërkesë tjetër të studentëve në lidhje me mjedisin. Programi i studimit Master ka një infrastrukturë¹⁷⁰ të mjaftueshme që përfshin ambiente për Leksione dhe Seminare në dy kampuse, atë të në rrugën e Kosovareve me sipërfaqe 2347 m² dhe kampusi në rrugën Frank Bardhi në Selitëku zhvillohet programime sipërfaqe 6451 m², që i plotësojnë kriteret, dhe sigurojnë një mësim normal të këtij programi studimi, bazuar edhe në numrin në ulje të studentëve¹⁷¹. Në dispozicion është edhe një sallë për aktivitete promovuese me 140 m² për organizimin edhetë konferencave të ndryshme.</p> <p>Stafi akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në zyra me sipërfaqe 183 m² të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal të punës. Ndërtimi i godinës së re në kampusin 2, sikurse dhe rikonstruktimi i godinës ekzistuese në këtë kampus, garantojnë kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në kuadër të kryerjes së detyrave në mënyrë profesionale dhe në krijimin¹⁷²</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, u konstatua në funksion të programit të studimit kishte mjedise mësimore si auditorë, salla mësimi të pajisura me mjete elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit, në mënyrë të veçantë të teknologjisë bashkëkohore në fushën e</p>

¹⁶⁹[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁰ po aty

¹⁷¹ po aty

¹⁷²[Evidenca 60.7. Infrastruktura akademike në funksion të programit të MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>mësimdhënies. Tërë ambientet mbuloohen me internet me rrjetin wifi¹⁷³, dhe pajisjet e nevojshme elektronike, si: kompjuter, laptop, printerë, skaner etj., si në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ¹⁷⁴.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. Mjediset përputhen me konceptin didaktik dhe objektivat e programit të studimit duke bërë të mundur mësimin interaktiv me në qendër studentin.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve, konstatojmë se Institucioni ka në dispozicion 3 laboratorë të teknologjisë së informacionit me kompjuterë të parametrave të fundit që janë në funksion të cilat janë në dispozicion të programit të <i>Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i>, në përputhje me kërkesat e lëndëve për një formim teorik dhe praktik të studentëve, përcaktuar në qëllimet e programit dhe mbështetje të nevojave të studentëve, me të gjitha programet dhe aplikacionet e domosdoshme për programin e studimit, si dhe mundësojnë mësimdhënien online me programet më bashkëkohore aktualisht në përdorim.¹⁷⁵ Laboratorët janë organizuar dhe strukturuar në mënyrë të tillë që studentët të pozicionohen tek ata kompjuterë sipas teknologjisë dhe programeve të përshtatshme për profilin e tyre të studimit¹⁷⁶</p>

¹⁷³[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁴[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁵[Evidenca 31. Raporti i ekspertit për infrastrukturën]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁶[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa ka në dispozicion të programit të studimit mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatsh për realizimin e praktikës profesionale me studentë, në godinat që zotëron ose në institucionet me të cilat ka marrëveshje për realizimin e praktikës profesionale të studentëve.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatohet se institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konstatuam se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:</p>

<p>gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p><i>Literatura bazë dhe ndihmëse</i>, e cila parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde.¹⁷⁷ Studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara :</p> <p>a) akses në JSTOR;</p> <p>b) nëpërmjet paraqitjes së linkut (Link aktiv) ku mund të gjendet materiali.</p> <p>Nga shqyrtimi programeve lëndore të programit të studimit të <i>Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i> janë përcaktuar si elementë edhe literatura bazë dhe e rekomanduar që u ofrohet studentëve qoftë fizike ashtu edhe digjitale (literaturë e cila gjendet ne bibliotekën e UniBa-s fizikisht dhe online e cila siguron marrjen e njohurive të domosdoshme për një formim profesional të studentëve¹⁷⁸.Kjo literaturë e përcaktuar nga lektori i lëndës është e përshtatshme dhe studentët mund ta aksesojnë në bibliotekë, duke hapur një kartelë studenti.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet nga vizita në institucion se Fakulteti si njësi kryesore bën përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e literaturës me botime të reja nëpërmjet përcaktimit të një fondi për bibliotekën, bazuar në kërkesat e Departamentit i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. (DSHETP) Nga ana tjetër edhe biblioteka ka një plan strategjik ku përfshihet edhe detyrimi i pedagogëve për të zgjeruar fondin e saj me çdo botim të tyre të ri.¹⁷⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka është e konceptuar si një mjedis i hapur dhe social formimi, ku studentë¹⁸⁰ dhe pedagogë mund të tërheqin për të lexuar çdo titull që kanë dëshirë në funksion të programit të studimit apo formimit të tyre të përgjithshëm e të vazhdueshëm akademik, kërkimor dhe shkencor. Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka pranë UniBa-s është e përqendruar në</p>

¹⁷⁷[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁸[Evidenca 30. Lista e teksteve/periodikëve në bibliotekë në funksion të programit të studimit]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁷⁹[Evidenca 30. Lista e teksteve/periodikëve në bibliotekë në funksion të programit të studimit]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁰[Evidenca 30.d. Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës në funksion të programeve të studimit]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>dy kampuse me një sipërfaqe 232.4 m², dhe me 114 poste leximi në shërbim të vazhdueshëm për studentë në çdo ditë të javës.¹⁸¹.</p> <p>Biblioteka garanton një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programeve të ndryshme të studimit, dhe në këtë aspekt edhe të programit të <i>Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i> që mbulon ky fakultet. Studentët kanë akses në shërbimet online (Katalogun online dhe Arkivën digjitale) që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se në bibliotekën e UniBa-s, si dhe nga verifikimii fondit të librave që disponon kjo bibliotekë,rezulton se në dispozicion te <i>Programitte Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim</i>, është një fond i mjaftueshëm librash në shqip dhe në gjuhë të huaj, dhe që janë në përputhje me materialin bazë të ofruara nga programet e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive mësimore të programuara në to. Biblioteka i jep mundësinë studentëve të shfrytëzojnë edhe fondin periodik, gazeta revista si dhe përdorimin e librarisë elektronikepër atë titull. Për këtë na u vu në dispozicion lista e titujve konform specifikave të programit.¹⁸²</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e Bibliotekës konstatohet se UniBa ka krijuar kushte dhe ka akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e bibliotekave online ku studentët marrin informacion si nga literatura shqipe dhe e huaj si: biblioteka JSTOR me libra dhe burime që përfshin 12 disiplina; EBSCO Open Dissertation; DOAJ (Directori of Open Access Journals).</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Rezulton se, Biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme në funksion të kërkesave të programit të e Studimit Master.Ambientet e bibliotekës janë të pajisura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidhje W-FI

¹⁸¹[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸²Evidenca 30. Lista e teksteve/periodikëve në bibliotekë në funksion të programit të studimit]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	<ul style="list-style-type: none"> • Tabela të bardha, projektorë dhe pajisje Smart. • Salla e pajisur me kompjuterë për përdoruesit. • Të gjithë studentët gëzojnë të drejtën e qasjes në ambientet e bibliotekës sipas orarit zyrtar.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, Biblioteka funksionon bazuar në përcaktimet erregullores së bibliotekës. Në faqen zyrtare të UniBa-s dhe në ambientet e bibliotekës janë të verifikueshme oraret e bibliotekës e cila qëndron e hapur çdo ditë të javës duke nisur prej orës 09⁰⁰-20⁰⁰. Numri i punonjësve për administrimin e bibliotekës është adekuat me numrin e studentëve.</p> <p>Orari lehtëson frekuentimin e bibliotekës, sipas mundësive të studentëve për të frekuentuar bibliotekën, pa i kufizuar në kohë. Biblioteka ka një person përgjegjës të angazhuar me menaxhimin dhe koordinimin e bibliotekës fizike dhe digjitale.</p>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka Universitare UniBa rezulton se ka një bashkëpunim të mirë mes strukturave të institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës si dhe përditësimin e këtij fondi si dhe nivelin e shfrytëzimit të tij. Biblioteka ka krijuar edhe klubin Books and Tech dhe ka ndërmarrë një sërë aktivitete promovuese për librin.
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive</i>

	<i>mësimore të programit Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nëpërmjet një sistemi të menaxhimit UniBa dhe Fakulteti si njësi përbërëse administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Institucioni siguron menaxhimin e informacionit dhe të dhënave për studentët dhe stafin akademik nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> a) web-it të institucionit. (www.umb.edu.al); a) komunikimit nëpërmjet postës elektronike; d) publikime në formë të printuar.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita në institucion rezulton se ka një sistem menaxhimi të informacionit, ku administrohet tërë dokumentacioni që lidhet me përditësimin e të dhënave të stafit akademik ndihmës akademik dhe administrativ lidhur me tërë veprimtarinë e tyre në kuadrin e realizimit të programit të studimit të <i>Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i> . Kjo realizohet me anë të sistemit elektronik të komunikimit me anë të emailëve në grup me domain-in umb.edu.al , me anë të klasave në 'Google Classroom' sipas lëndëve, grupeve, viteve dhe programeve të studimit, me anë të komunikimit në 'Google Meet', si dhe me anë të grupeve në rrjete sociale e platformat dhe aplikacionet e komunikimit whatsapp.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të	Studentëve dhe pedagogëve iu është mundësuar një Manual për përdorimin e këtyre sistemeve. ¹⁸³ Sistemi i menaxhimit pranë FSHSTS si

¹⁸³[Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit studentor për administrim] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	pjesë e veprimtarisë të sistemit të UniBa-s i cili administron të dhëna për studentë dhe staf akademik i bën të aksesueshme nepërmjet faqes zyrtare të institucionit, njësive përkatëse, Intranetit dhe platformave online. Ky sistem siguron të akses të informacioneve dhe dokumentave, për studentë nepërmjet sekretarisë mësimore, e cila vë në dispozicion të tyre si planin mësimor, syllabeset, të dhëna të tjera kur kërkohen kopje fizike e tyre.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Siç rezulton dhe nga vizita ne institucion sistemi i menaxhimit në UniBa ka të integruar platforma dhe module ¹⁸⁴ që mundësojnë komunikimin ndërveprues dhe shkëmbimin e informacionit të brendshëm. <ul style="list-style-type: none"> • Google Classroom • Google Meet' • Aplikacionet e komunikimit whatsapp.¹⁸⁵.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Bazuar në rregullore të funksionimit dhe vlerësimit të veprimtarisë akademike, Sekretaria mësimore, Njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe cilësisë, monitoron në kohë reale tërë aktivitetin akademik dhe administrativ si dhe publikon ne faqen zyrtare rezultatet e kësaj veprimtarie. ¹⁸⁶¹⁸⁷
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga verifikimi në Faqen zyrtare të UniBa-së mund të konfirmojmë se ne faqen zyrtare të institucionit ka të dhëna për departamentin pedagogët, studentët, urdhra dhe udhëzime, veprimtari si dhe informacion që lidhet më programin e studimit. Ky përditësim bëhet në Rrjetet Sociale: Facebook, Instagram, YoutUniBa, Twitter: Universiteti “Barleti”, Trajnime Barleti, Klubet Studentore Barleti, si dhe në web: www.umb.edu.al ;
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet disa sistemeve, duke</i>

¹⁸⁴ po aty

¹⁸⁵[Evidenca 38.g. UniBa-google-classroom-manual-pedagogu]giendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸⁶Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> (Rubrika Dossier)

¹⁸⁷Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e përfomancës. (Ref: Evidenca Nr. 12.)

	<i>administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në RVB, IAL UniBa harton çdo vit nëpërmjet Drejtorisë së Financave një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat lidhur me veprimtarinë akademike dhe shkencore të institucionit, duke përfshirë këtu edhe shpenzimet që lidhen me programet e studimit që ajo ofron. Raporti ndërtohet mbi bazën e historikut të kostove dhe raportit tarifë-shpenzime ¹⁸⁸ . Në këtë aspekt përfshihen edhe mbulimi i realizimit të programit të studimit të <i>Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i> .

¹⁸⁸[Evidenca 40. Të dhëna, Plani i financimit të programit të studimit] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>UniBa si institucion nëpërmjet Zyrës së financës dhe koordinimit financiar ka një plan financimi për tërë strukturat universitare i cili miratohet në Senatin akademik të institucionit dhe në Bordin e Administrimit. Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatojmë se është planifikuar sipas zërave të caktuar në buxhet, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, mirëmbajtjen e mjediseve, si dhe shpenzime për bibliotekën online.¹⁸⁹</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr.83, datë 03.02.2016, auditimit të brendshëm në Sektorin publik, UniBa ka njësi auditimi, e cila kryen rregullisht auditim të përvitshëm duke vlerësuar dhe dokumentuar sesa efikas është financimi dhe si të rikuadrojë dhe përmirësojë vazhdimisht të ardhurat dhe si të reduktojë kostot, për të pasur një stabilitet dhe mbarëvajtje afatgjatë sa më të shëndetshme.¹⁹⁰</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa bën çdo vit një analizë financiare të përgatitur nga Zyra e financës dhe paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zërave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit, duke e bërë të aksesueshëm për të gjitha njësitë e institucionit.</p>

¹⁸⁹[Evidenca 40. Të dhëna, Plani i financimit të programit të studimit] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁰[Evidencë 39. Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimii dokumentacionit në Zyrën ekonomike dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit të <i>Ciklit të Dytë "Master Profesional"</i> në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të gjithë programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxhetii përgjithshëm, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vinë nga projektet.¹⁹¹</p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në RVB, institucioni harton buxhetin me baza vjetore. Ekziston një procedurë e brendshme e planifikimit të buxhetit. Institucioni ka një plan financimi i cili mbulon shpenzimet për shumë aspekte.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

¹⁹¹Po aty

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UniBa si institucion ka ngritur për të gjitha programet e studimit një strukturë e mirëorganizuar për shërbimet studentore si : “Zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit”; “Sekretaria mësimore”; Zyra e Alumnit dhe Karrierës” ku janë përcaktuar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore një sërë procedurash që lidhen me mbulimin e studentëve nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve.¹⁹²</p> <p>Nga verifikimii dokumentacionit si dhe nga takimi me studentë, rezulton se studentët njihen që fillim me kriteret e pranimit dhe të konkurrimitnëpërmjet publikimit në faqen zyrtare nga ana e institucionit, me planin mësimor dhe kërkesat e programeve të lëndëve, mënyrën e komunikimit dhe të ankimimit, përparimit të tyre, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit si dhe për studentët e ftuar.¹⁹³</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet që UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit ndjek procedura transparente për pranimet në ciklin e dytë të studimeve të <i>Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim"</i> institucioni ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi¹⁹⁴ Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p> <p>Politikat, të materializuara në rregullore, garantojnë kushte të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrjen e shërbimeve në institucion dhe ushtrimin e të drejtave të tyre sipas parashikimeve të rregullores së studimit dhe atë të programit. • në pajisjen me një kartë studenti • të shprehë mendimin e tij për punën e pedagogut. • të shprehë dhe të shkruajë lirisht dhe drejtpërdrejt Dekanit për studentin mendimet, dëshirat, shqetësimet dhe kërkesat e tij.

¹⁹²Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al> (Studentët,Pranimet, Karrierë)

¹⁹³Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al> (Studentët,Pranimet, Karrierë)

¹⁹⁴po aty

	Pranë institucionit funksionon edhe “Zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit” e cila zbaton rregulloren dhe kriteret e përcaktuara nga institucioni konform legjislacionit në fuqi.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret e pranimit përzgjedhja e kandidatëve për çdo program studimi hartohet nga institucioni sipas njësave përkatëse dhe publikohet në faqen zyrtare të tij. Pranë institucionit funksionon edhe “Zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit” e cila zbaton rregulloren dhe kriteret e përcaktuara nga institucioni konform legjislacionit në fuqi ¹⁹⁵ . Çdo i interesuar mund t’i aksesojë ato në faqen zyrtare të internetit të Universitetit. http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html http://umb.edu.al/transferohu.html http://umb.edu.al/pranimet.html
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rezulton se institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online, kriteret e pranimit për secilin program studimi. http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html Në rregulloren e UniBa-s si dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë të gjitha procedurat e pranimit, përparimit të transferimit dhe të vlerësimit të studentëve, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë në faqen zyrtare të institucionit. Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Sociale , Turizmit dhe Sportit rezulton se cdo vit akademik i bën të ditura studentëve të nivelit Master dhe palëve të tjera të interesuara kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të vecanta, informacion mbi organizimin dhe përmbajtjen e Programit të studimit <i>Master Profesional në Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim”</i> . Kjo realizohet nepërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale të institucionit, faqes shtetërore dhe portalit U-Albania si dhe fletëpalosjeve dhe javës së informimit. ¹⁹⁶
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta	UniBa vë në dispozicion të të interesuarve një informacion të detajuar në lidhje me kriteret e përgjithshme të regjistrimit në programin e studimit

¹⁹⁵[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2021-2022] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁶ Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al>, (Rubrika Pranimit)

për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<i>Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim", i cili shpërndahet përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit.</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren e programit të studimit të <i>Ciklit të Dytë Master Profesional Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim"</i> konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë Bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës Kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit në programin e studimit, janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Regjistrimi i studentëve shqiptarë nga trojet dhe të studentëve të huaj bëhet mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. ¹⁹⁷ .			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën Pranimet (Tarifa dhe Bursa), publikohen të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për t'u ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. Në takimin me studentë dhe në sekretarinë mësimore u konfirmua ky fakt. Miratimi përfundimtar i tyre bëhet nga Bordi i Administrimit ¹⁹⁸ .			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron institucioni, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të web-it.</i> <i>Gjithashtu, konstatohet se institucioni, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁹⁷Evidenca 60.3. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2023-2024 gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁹⁸Evidenca 1.2. Rregullorja e Universitetit "Barleti", Neni 84 gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Guel

fr

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UniBa ka një strukturë efektive dhe vë në dispozicion të studentëve të programit një informacion të vazhdueshëm lidhur me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin, e sanksionuar në rregulloren e programit të studimit. Në rregulloren e programit të studimit¹⁹⁹ janë parashikuar procedurat dhe informacioni i detajuar për të gjithë procesin dhe përparimin akademik.</p> <p>Informimi i studentëve bëhet në javën e parë të mësimit nga Koordinatori i Departamentit dhe pedagogët në prezantimin e planit mësimor syllabuseve, dhe guidës të studentëve, si dhe nga Sekretaria mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UniBa ka një sistem informimi të studentëve të pasqyruar në Rregulloren e studimit , Rregulloren e Transferimit të studentëve, lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme. E gjithë procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit parashikohet në Rregulloren e Transferimeve²⁰⁰, Rregullore e Programit të Studimit²⁰¹ dhe në Manualin Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim,²⁰².</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa ka ngritur një sistem informimi për studentëve që mundëson ato të njihen që në ditën e parë të mësimit në lëndët që përmban kurrikula si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimin të cilat janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, dhe në rregulloren e studimit të këtij program studimi. Studentët shfrytëzojnë edhe faqen zyrtare portalin studentor ku publikohen të dhëna të përditësuara lidhur me programin.²⁰³</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Kriteret e diplomimit të studentëve janë të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Në programin e studimit <i>Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim"</i> prova finale zhvillohet në trajtën e provimit të formimit dhe</p>

¹⁹⁹Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁰Evidenca 19. Rregullore për Transferimin dhe Regjistrimin në Programe të Dyta] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰¹Evidenca 3. Rregullore e programit të studimit MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰²Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰³Faqe zyrtare UniBa <https://umb.edu.al>) Fakulteteti SHSTS rubrika programet e studimit.

diplomimit në programin e studimit.	me punim diplome. Studentët me mesatare mbi 9.5 mund të përgatitin punim diplome. Departamenti ka ndërtuar programin e provimit të formimit, i cili përmban çështjet kryesore të të gjitha lëndëve të planit mësimor, por dhe databazë të pyetjeve të programit që lidhen me kompetencat e domosdoshme profesionale të fituara. ²⁰⁴ Për vitin akademik 2022-2023 nuk rezultojnë studentë të diplomuar me punim diplome.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën Studentët -Alumni jepet një informacion i plotë lidhur me programin e studimit, kriteret dhe procedurat e rregjistrimit. ²⁰⁵ Në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit ²⁰⁶ . Po kështu institucioni shfrytëzon Guidën studentore' rjetet sociale dhe javën e informimit ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program.			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se institucioni ka ngritur një sistem informimi të studentëve lidhur me programin e studimit që para rregjistrimit të kandidatëve dhe gjatë vitit për përmbajtjen, ecurinë e vlerësimit të tyre si dhe diplomimit. Institucioni ka e zbaton nje udhëzues "Paketa e provës finale" në ndihmë dhe orientim të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	Konstatojmë se Institucioni u jep mundësi studentëve të informohen lidhur me programin e studimit strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen

²⁰⁴[Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁵[Evidenca 49. Programi "Java e orientimit të studentëve e vitit akademik 2023-2024"] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁶[Evidenca 41.strategjia e marketingut dhe rekrutimit] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>nëpërmjet një sistemi informacioning drejtime të ndryshme, dhe njësi të caktuara të institucionit etj. Në takimin me studentë u konfirmua se nëpërmjet Koordinatorit të Departamentit; Javës së parë të informimit të studentëve; materialeve të ndryshme në hollin e fakulteti (postera, broshura, materiale audio-vizive); klubet studentore, ata marrin një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën dhe organizimin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>FSHSTS-it në zbatim të rregullores të UniBa-s ka përcaktuar përgjegjësinë e tërë strukturave të saj për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin e studimit <i>Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim"</i>²⁰⁷. Në takimin me studentë u deklarua se ato merrnin informacion si nga pedagogët, Koordinatori i departamentit, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UniBa-së.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur si dhe nga faqja zyrtare e institucionit UniBa²⁰⁸ rezulton se ka një sërë veprimtarish që organizohen dhe njësisht (Bordi i karrierës; Zyra e Alumnit dhe karrierës; Dekani i studentëve) që funksionojnë lidhur me orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh me kompani dhe institucione shtetërore dhe private që i orientojnë ato drejt një punësimi të suksesshëm.²⁰⁹ Nga takimi me studentë u konfirmua se ata merrnin vazhdimisht informacion nga zyra e programit të karrierës për mundësitë e punësimit të tyre dhe informacione të tjera të ndryshme si intervista pune, testim orientim dhe këshillim nga ekspertë karriere. Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore publike dhe jopublike^{210, 211, 212}.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,</p>	<p>UniBa si institucion ka vënë në dispozicion të studentëve të një sistemi menaxhimi efektiv (Sekretari mësimore; Dekani i studentëve; Koordinatori i Departamentit) që informojnë studentët për çdo aspekt të veprimtarisë së procesit mësimor dhe veprimtarive të tjera, nëpërmjet komunikimeve</p>

²⁰⁷[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰⁸Marrëveshje dhe Bordii Karrierës. (Ref: Evidenca Nr. 10.3 & 29)

²⁰⁹Marrëveshje dhe Bordii Karrierës. (Ref: Evidenca Nr. 10.3 & 29)

²¹⁰[Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]gjendet në:

<https://ascal.al/sq>

²¹¹[Evidenca 22.2. Raportim vjetor Alumni]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹²[Evidenca 22.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentë]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	elektronike dhe portalit studentor për ti mundësuar atyre një informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin. ^{213, 214, 215} .								
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se institucioni UniBa ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit të aksesueshëm edhe në faqen zyrtare, ²¹⁶ platformën Google Classroom ²¹⁷ , ku studentët marrin informacion për veprimtarinë mësimore gjatë frekuentimit të programit, regjistrimet në provime dhe rezultatet e vlerësimit, të dhëna për lëndët, mjetet didaktike dhe tekste. ^{218, 219, 220, 221} .								
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që në faqen web-it gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, etj. Njësia informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme që institucioni organizon. Njësia informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme që institucioni organizon.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

²¹³Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al> Rubrika studentët.

²¹⁴[Evidenca 17.3. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit, aneks 4] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁵[Evidenca 29.a. Manual i mësimdhënies online]

²¹⁶[Evidenca 29.a. Manual i mësimdhënies online] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁷[Evidenca 29.a. Manual i mësimdhënies online] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁸[Evidenca 29.a. Manual i mësimdhënies online] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²¹⁹[Evidenca 2.1.b. Plani mësimor Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe komunikim"] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁰[Evidenca 17.3. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²¹po aty

Guat

[Signature]

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit në Sekretarinë mësimore rezulton se FSHSTS disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për herë të parë, për vitin akademik 2022-23 dhe 2023-24, por meqëse ky program është hapur në Tetor 2022 nuk ka të diplomuar pasi është viti i dytë.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, për programin e studimit ka statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi. Ky informacion gjendet pranë sekretarisë mësimore.²²²</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:²²³</p> <table border="1" data-bbox="598 840 1380 1003"> <thead> <tr> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3 studentë</td> <td>2 studentë</td> </tr> </tbody> </table>	2022-2023	2023-2024	3 studentë	2 studentë
2022-2023	2023-2024				
3 studentë	2 studentë				
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësive si dhe aktivitetit të sektorëve të këtij institucioni si Sekretarisë mësimore Dekanit të fakultetit, Departamentit dhe Alumni rezulton se këto njësi²²⁴ menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit, dhe i kanë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit. Arritjet akademike të studentëve janë të aksesueshme edhe nepërmjet programit “Portali studentor”²²⁵</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin</p>	<p>Në manualin e cilësisë që disponon UniBa rezulton se është përcaktuar qartë kontrolli periodik nga Njësia ezhvillimit të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë dhe Zyra e performancës, për ecurinë e programit. Njësia ushtron kontrolle mbi njësitë përgjegjëse për standardet e cilësisë të brendshme të</p>				

²²²Evidenca 26.2. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²³ Evidencë 68 Aneks tabelat përmbledhëse.

²²⁴ Po aty

²²⁵ Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al> Rubrika studentët (Portali studentor)

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	institucionit, kurrikulave dhe mësimdhënies, marrin feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, dhe hartojnë raporte periodike që i kalojnë Rektorit. ²²⁶			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojmë se Departamenti që mbulon programin e studimit <i>Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë dhe Komunikim"</i> ka një dokumentacion lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve vetëm në hyrje për këtë program studimi pasi nuk ka akoma studentë të diplomuar, që verifikohet në dokumentacionin e Sekretarisë mësimore. ^{227, 228, 229} . Për vitin akademik 2022-2023 nota mesatare në hyrje është 6.3, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 nota mesatare është 7.8.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalje, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

²²⁶ po aty gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁷[Evidenca 35. Analiza vjetore e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2023] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁸Evidenca 32.a Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentët e MPMGJK] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²²⁹ po aty

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UniBa në zbatim të Statutit, Politikave të mbështetjes së studentëve dhe strukturave organizative të tyre ka të përcaktuar përfshirjen e studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik;²³⁰ • Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta;²³¹ • Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë;²³² • Dekanatin e Fakultetit;²³³ • Këshillin/qeverinë e studentëve;²³⁴ • Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët.²³⁵
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga intervistat me studentet e programit të studimit rezulton se ata janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të UniBa-s. UniBa si institucion dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit si njësi përgjegjëse e programit të studimit rezulton se ka një përfshirje reale të studentëve në vendimmarrje dhe që përpiqen të japin kontribut në përmirësimin e veprimtarinë e institucionit. Kështu në takimin me studentë u theksua se pyetëtori që realizohet për të dhënë opinion mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, i aksesueshëm nga të gjithë, është përfshirë në raportin e punës vjetore të departamentit për përmirësimin e kurrikulës dhe performancës së pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi. Një student i këtij programi është përfshirë në këtë RVB.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë rezulton se gjatë tërë vitit akademik nga sektorët përgjegjës NJSBC ushtrohen kontrole mbi ecurinë e procesit mësimor në programet e studimit që mbulon ajo, me instrumente që sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe pasqyrohen në raportin vjetor të njësisë²³⁶. Nga takimi me studentë u rezultoi se studentët janë të lirë të marrin pjesë një herë në muaj në mbledhjet e hapura të departamentit si mundësi për të dhe kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit.</p>

²³⁰ po aty

²³¹ po aty

²³²[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Barleti"] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³³[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit "Barleti"] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁴[Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁵Evidenca 20.1. Rregullore e Organizimit të Zgjedhjeve për Qeverinë Studentore]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁶ po aty

departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.									
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga shqyrtimii dokumentacionit rezulton se Fakulteti Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ka bazuar në rregulloren e studimit të UniBa-s barazinë dhe ndershmërinë në vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit, dhe të rishikimit të vlerësimit, të studentëve. ²³⁷								
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit.	UniBa në dispozicion të studentëve të regjistruar në programin e studimit (si edhe rezulton nga dokumentacioni paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion), njësi shërbimi dhe informimi të studentëve. Njësitë e posaçme ²³⁸ : Zyra e Pranimi të studentëve; Sekretaria Mësimore; Dekani i Studentëve; Kordinatori i Departamentit; Zyra e Alumnit dhe dhe Karriera; Portali Studentor si dhe klubet e ndryshme studentore

²³⁷[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit "Barleti", neni 88] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²³⁸[Evidenca 1.2. Procedurë ankimimi për studentët, rregullore UNIBA-s, neni 89] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	etj, informojnë apo mbështesin studentët në veprimtarinë e tyre mësimore apo aspekte të tjera të jetës së tyre studentore ²³⁹ .
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UniBa si institucion rezulton se ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimore të tyre, duke e sanksionuar me rregulloren “Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve” mënyrën e funksionimit të këtij sistemi. Për ndjekjen dhe marrjen informacion për përparimin e studentëve rezulton se funksionon Portali studentor, ku studentët rregjistrohen nga sektori i IT.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe nga takimi me studentë rezulton se ata marrin shërbim mbështetës lidhur me planifikimin e karrierës dhe realizimin e praktikës profesionale, nga Koordinatori i Departamentit ; Dekani i studentëve; Zyra e Alumnit dhe Karrierës; si dhe nga pedagogu përkatës për praktikën profesionale. ²⁴⁰ Ne faqen zyrtare të institucionit janë publikuar një sërë veprimtarish që lidhen me këtë informim të studentëve ²⁴¹
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe	Zyra Alumnit dhe Karrierës ndjek studentët pas diplomimit duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me to nëpërmjet postës elektronike, pyetësorëve, aktiviteteve promovuese, dhe harton plane dhe raporte vjetore për gjurmimin e studentëve raporte të cilat janë të aksesueshme për të gjitha njësitë e institucionit në faqen zyrtare të institucionit. ²⁴²

²³⁹[Evidenca 20. Rregullore e Zyrave Studentore] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁰[Evidenca 20. Rregullore e Zyrave Studentore] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴¹[Evidenca 1.2. Rregullore e UniBa, Shtyllat e aktiviteteve kryesore në UniBa] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴²[Evidenca 20. Rregullore e Zyrave Studentore, Neni 9] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton se institucioni UniBa ka të hartuar një sërë manualesh të ndryshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave mësimore si: udhëzues për përdorimin e metodave mësimore. Manualin për mësimdhënien online; Guidën për mësimdhënien online; Udhëzues për përdorimin e strukturës së informacionit TIK. Disa nga dokumentet që janë hartuar për garantimin e kësaj të fundit, janë:

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë;²⁴³ ➤ Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë;²⁴⁴ ➤ Udhëzues për metodat e mësimdhënies;²⁴⁵ ➤ Udhëzues për përdorimin e strukturës së informacionit TIK, etj ;²⁴⁶.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Institucioni UniBa-a nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj si: Njësia e zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë; Zyra e Vlerësimit të performancës; Njësitë bazë të fakulteteve, kanë hartuar dhe zbatojnë mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin periodik të procesit të mësimdhënies.²⁴⁷</p> <p>Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut nga studentët, Formulari i vlerësimit të pedagogut nga kolegët janë mekanizma ku merret informacion dhe analizohet nga njësitë në analizat vjetore të tyre.</p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>Bazuar në “Rregulloret e studimit” , “Manualin e Cilësisë” institucioni ka garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve.Përdorimiinstrumenteve të tillë si pyetësorët me studentët nga NJZHKC-së dhe Zyra e vlerësimit të Performancës për vlerësimin e performancës së pedagogëve dy herë në vit para provimeve vlerësimi i pedagogëve nga kolegët, është një mundësi e mirë për përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</p> <p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.²⁴⁸</p> <p>Po kështu rezultoi se ka një sistem për marrjen dhe menaxhimin e ankesave të studentëve (mishëruar kjo në rregulloren e UniBa-s dhe formularin për transparencë në vlerësimin e studentëve) e konfirmuar kjo edhe nga takimi me studentët.</p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	<p>Konstatohet se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie që bëjnë publike rezultatet e vlerësimit është NJZHKC-ja e cila përgatit një raport për gjetjet dhe rezultatet e këtij procesi.</p>

²⁴³[Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁴[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁵[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁶[Evidenca 17.3. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁷[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁴⁸Evidenca 16.7. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri I]gjendet në:

<https://ascal.al/sq>

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJZhKC-ja informon rektoratin, me rekomandimin e të cilit raportet u përcillen drejtuesve të departamenteve dhe përmes tyre në mënyrë konfidenciale në stafin përkatës. Në përfundim të vitit akademik, NJZhKC-ja harton raportin vjetor ²⁴⁹ përvlerësimin e cilësisë në UniBa. Përmbledhja e raportit bëhet publike në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën “Dossier”.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UniBa ka krijuar një përvojë pozitive në promovimin e praktikave të mira që dalin nga mekanizmat që përdor për vlerësimin e performancës dhe veprimtarisë mësimore në institucion, duke përdorur aplikimin edhe pjesëmarrjen në projekte dhe qendra kërkimore, mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore, rishikim të pagës etj, për të nxitur personelin për përmirësim të mësimdhënies. ²⁵⁰			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga faqja zyrtare e UniBa-se rezulton se institucioni ka ngritur një strukturë të plotë për sigurimin e cilësisë në shkallë fakulteti dhe institucioni. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë: → Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë; → Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. ^{251 252} → Rregullore e UniBa-s ²⁵³ .

²⁴⁹Evidenca 50.6. Raport vjetor përvlerësimin e cilësisë në UniBa]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁰[Evidenca 60.2. Promovim i shembujve të praktikave të mira]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵¹[Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵²Evidenca 16.2. Rregullore e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵³[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Barleti”]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

me aktet rregullatorë institucionale.	<p>→ Komisioni i Vlerësimit të Performancës,²⁵⁴</p> <p>→ https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Studentët kanë përfaqësimin e tyre në këto njësi²⁵⁵, dhe rezulton se ekspertiza nga bashkëpunëtorë dhe eksperte të jashtëm realizohet nga aktorët e jashtëm të biznesit bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni e konsiston në dhënie sugjerimesh lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe përmirësimin të programeve të studimit.²⁵⁶</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Konfirmojmë se Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit bazuar në “Rregulloret e studimit” “Manualin e Cilësisë” ka garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Përdorimi i instrumentave të tillë si pyetësorët me studentët nga NJZHKC-së dhe Zyra e vlerësimit të Performancës për vlerësimin e performancës së pedagogëve dy herë në vit para provimeve, vlerësimi i pedagogëve nga kolegët, është një mundësi e mirë për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Po kështu rezulton se ka një sistem për marrjen dhe menaxhimin e ankesave të studentëve (sanksionuar kjo në rregulloren e UniBa-s dhe formularin për transparencë në vlerësimin e studentëve) e konfirmuar kjo edhe nga takimi me studentet.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin egjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatorë institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni UniBa²⁵⁷ për grumbullimin e të dhënave për pasqyrimin e gjendjes në mësimdhënie dhe kërkim reflektuar në analizat vjetore të veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësisë kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në instrumente të qartë e të matshëm (si vetdeklarimet e anëtarëve të stafit akademik, kontrollet e realizuar përmësimdhënien, pyetësorët me studentë, vlerësimi nga kolegët, etj).²⁵⁸</p>

²⁵⁴[Evidenca 12.a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁵⁵

²⁵⁶[Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit] gjendet në:

<https://ascal.al/sq>

²⁵⁷Evidenca 50.7. Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]

²⁵⁸po aty

Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë senë varësi të rezultateve, bazuar në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Rregulloren për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës, institucioni bën promovime nxitëse, si emërimin në pozicione të caktuara, mbulimin e një pjese të shpenzimeve për konferenca apo aktivitete të tjera kërkimore. Këto bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e departamentit dhe pasqyrohen edhe në dokumentin e raportit të punës vjetore të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni përdor mekanizma të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyrjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim,” në shërbim të akreditimit, në përputhje me Manualin për sigurimin e cilësisë. ²⁵⁹ Gjetjet e NjZHKC pasqyrohen në raportet vjetore të njësisë baze fakultetit dhe institucionit në tërësi dhe publikohen në faqen zyrtare. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim” kryhet në mënyrë periodike, në raportet vjetore të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ²⁶⁰ , që është përgjegjëse për këtë program studimi. ²⁶¹

²⁵⁹Manual i Cilësisë (Ref: Evidenca Nr. 60.)

²⁶⁰[Evidenca 60.5. Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2021-2022] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

[Evidenca 60.6. Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023

[Evidenca 16.7. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri I]

[Evidenca 16.8. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri II]

²⁶¹[Evidenca 50.6. Raport vjetor përvlerësimin e cilësisë në UniBa] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga verifikimi i raporteve vjetore të punës mësimore dhe shkencore të departamentit dhe të institucionit në tërësi, rezulton se bazuar në rezultatet e vlerësimit të përfituara nga pyetësorët me studentë, vlerësimin e kolegëve dhe vetëvlerësimit të pedagogëve, nga njësitë përkatëse, verifikohen rezultatet e pritshme, bëhet edhe evidentimi i praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe përcaktohen mangësitë, dhe kërcënimet lidhur me programet e studimit, dhe jepen rekomandime për përmirësimin e punës mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>➤ Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konfirmojmë që UniBa në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta që janë^{262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 269, :}</p> <p>Raportim i pedagogëve për punën; Vlerësimet online cdo semestër nga studentët të mësimdhënies; Formati i vlerësimit nga kolegët të stafit akademik; Formati i vetvlerësimit; Vëshgime në auditor;</p>

²⁶²[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶³[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁴[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁵[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁶[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁷[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁸[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶⁹[Evidenca 16.3. Format i raportimit të punës semestrale] gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Mbledhje mujore në departament për ecurinë e procesit mësimor; rezultatet e provimeve etj</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Konfirmojmë që UniBa në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta, për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë : Sondazhe me studentët aktual që vazhdojnë studimet; Sondazhe dhe mbledhje informacioni nga studentë të diplomuar nga Alumni;</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në këtë proces. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes të studentëve në komisionin e sigurimit të standardeve dhe cilësisë, të përfshirjes së tyre në tërë grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve sipas njësisë, bashkëpunimin me studentët e diplomuar nëpërmjet Alumnit dhe bashkëpunimi i ngushtë me përfaqësues të bizneseve në rolin e ekspertëve të jashtëm. Institucioni garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të tij në vizitën në institucion rezulton se UniBa ka të përcaktuar në rregulloret e saj dhe të njësive që merren me sigurimin e cilësisë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për një sigurim të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Këto përgjegjësi dhe detyra janë përcaktuar në Rregulloren e UniBa-s; në Rregulloren e Departamentit; Rregulloren e programit të studimit; Rregullore për vlerësimin e performancës; Rregullore e njësisë të zhvillimit të kurrikulave dhe cilësisë (faqja zyrtare); Manuali i cilësisë; Plani i punës për zhvillimin e kurrikulave dhe cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon UniBa lidhur me sigurimin e cilësisë të programit mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit, Institucioni ngarkon me përgjegjësi njësinë kryesore dhe bazë, koordinatorin e departamentit si dhe të gjitha strukturat ndihmëse të saj.</p> <p>Në kuadër të akreditimit të programit është ngritur edhe grupi i vlerësimit të brendshëm me pjesëmarrjen e stafit, studentëve, dhe në urdhrin nr. 43, datë 22.12.2023 janë përcaktuar qartë edhe strukturat akademike dhe administrative mbështetëse për dhënien e informacionit që kërkohet.</p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UniBa, konstatojmë se në Statutin (neni 3, pika 3) dhe Kodin e Etikës²⁷⁰ të institucionit, në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standardet dhe integriteti akademik i stafit, dinjiteti njerëzor, duke siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes të studentëve në komisionin e sigurimit të standarteve dhe cilësisë, të përfshirjes së tyre në tërë grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve sipas njësisë, bashkëpunimin me studentët e diplomuar nëpërmjet Alumnit dhe bashkëpunimi i ngushtë me përfaqësues të bizneseve në rolin e ekspertëve të jashtëm. <i>Sugjerojmë që këto ekspertë të jenë pjesë e dokumentuar e grupeve të vlerësimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të institucionit në rubrikën “Sigurimi i cilësisë” janë bërë publike të gjitha rregulloret, strukturat dhe veprimtaritë që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html https://umb.edu.al/neës4901.html https://umb.edu.al/neës5125.html https://umb.edu.al/neës5030.html
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga vizita në institucion dhe verifikimi në faqen zyrtare të tij rezulton se parimet mbi të cilat ndërtohet sigurimi i brendshëm i cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Raporti vjetor ²⁷¹ i NJZhKC-së publikohet duke respektuar lirinë akademike, ruan etikën akademike dhe respekton legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. https://umb.edu.al/dossier-uniba.html
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit bëhet analiza SWOT ku evidentohen si pikat e forta ashtu edhe mangësitë, rekomandimet përkatëse si objekt punë për njësitë për hartimin e një plani masash për përmirësimin e punës. Në raportin e saj vjetor, NJZhKC-ja rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ajo dhe gjithë strukturat drejtuese të UniBa-s ^{272, 273} .
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në takimin me stafin akademik dhe me studentë konfirmohet se tërë procesi i punës procedurat dhe instrumentet e përdorur për sigurimin e cilësisë, ku edhe studentët janë pjesë e tij, ka pasur një ndikim pozitiv në përmirësimin cilësor të programit të studimit, sidomos në përmirësimin e syllabuseve, të metodologjisë dhe veprimtarive jashtë procesit mësimor.

²⁷¹Evidenca 50.6. Raport vjetor përvlerësimin e cilësisë në UniBagjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁷²Evidenca 20.4. Formulari i vlerësimit të studentëve për lëndën]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁷³ po aty

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UniBa nëpërmjet veprimtarive periodike të organizuara me stafin akademik dhe studentë, si dhe me manuale të shumtë të publikuar në faqen zyrtare të institucionit lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ka siguruar një ndërgjegjësim të tërë aktorëve pjesëmarrës në procesin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të programeve të studimit. https://umb.edu.al/news4901.html https://umb.edu.al/news5125.html https://umb.edu.al/news5030.html			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se UniBa si institucion ka krijuar një kulturë të brendshme për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë nëpërmjet politikave që ndjek, proceseve dhe veprimtarive që organizon.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	---------------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional
Mësuesi në “Gjuhë dhe Komunikim”, Universiteti “Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Hartimi i programit që ofron Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional në IAL UniBa, në koherencë me vizionin, misionin dhe planin e zhvillimit strategjik të institucionit si dhe mbështetja dhe përdorimi i një kornize rregullatore, e cila ka siguruar zbatimin e kërkesave të ligjit dhe të kërkesave të tregut.
2. Kuadri i përgjithshëm rregullator i UniBa është i plotë dhe ekziston një ndarje e qartë e detyrave që duhet të kryejë çdo njësi e institucionit. Në funksion të zbatimit të programit të studimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë brenda dhe jashtë vendit. Në përfundim të çdo viti akademik, nga njësia kryesore dhe njësia bazë, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë së formimit të studentëve.
3. Rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Trajnimit Profesional, që është njësi përgjegjëse për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", ka përvojën, kapacitetet, si edhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit të studimit. Programi i Studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UniBa, si edhe në përputhje me fushën akademike të studimit të FSHSTS dhe të Departamentit të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.
4. Programi i studimit Master Profesional Mësuesi “Gjuhë dhe Komunikim” është një program bashkëkohor. Institucioni ka ngritur njësinë “BRIDGE” (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), e cila ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.
5. Gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim", për vlerësimin e studentëve, përdoren kritere të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.

6. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Trajnimit Profesional, në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke qenë në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të tjerë të interesuar si studentët, pedagogët dhe partnerë të tjerë të shoqërisë dhe komunitetit të dijes.
7. Zbatimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi " Gjuhë dhe Komunikim", parashikon zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme me natyrë teknologjike/ pedagogjike/ gjuhësore /komunikuese. Këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndëve të ndryshme dhe programit të studimit.
8. Drejtim, administrim dhe organizim i nivelit cilësor nga Përgjegjësi i Departamentit dhe angazhim i dukshëm i pedagogëve në mësimdhënie dhe kërkim shkencor më përgjithësi
9. Infrastruktura moderne për mësimdhënie, hapësirat e nevojshme dhe adekuate, për mësimdhënie dhe studim individual, të bollshme dhe të mirë organizuara, bibliotekë funksionale në shërbim të stafit dhe studentëve për të përmbushur rezultatet e pritshme në programin e studimit Master Profesional në Mësuesi "Gjuhë dhe Komunikim" që ofron ky institucion.

Pika të dobta

1. Numri i ulët i studentëve të regjistruar në këtë program studimi si rrjedhojë e uljes së numrit të popullatës dhe rënies së interesit për ndjekjen e programeve të mësuesisë **(Standardi V.4,kriteri 2).**
2. Kërkohe angazhim më i madh në njohjen dhe publikimin në detaje të programit të studimit Master Profesional Mësuesi në " Gjuhë dhe Komunikim" jo vetëm përmes takimeve në rrethe dhe shkolla, por edhe në sitin e UniBa. Reklamim më i madh në mediet e ndryshme sociale dhe bashkëpunim me përdoruesit e këtyre medieve për tregimin e vlerave të këtij programi studimi. **(Standardi IV.4,kriteri 6)**
3. Vëmendje më e madhe në financimin e kërkimit shkencor për këtë program studimi i cili mund të funksionojë si program master i dytë për rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe në plotësimin profesional të gjithë mësuesve dhe drejtuesve të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme **(Standardi II.7,kriteri 1)**

G. et

fr

Rekomandime

1. **Rekomandohet** që UniBa të parashikojë rritjen e buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për mbështetjen e botimeve të artikujve me faktor impakti".
2. **Rekomandohet** që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master Professional Teaching in "Language and Communication", "Barleti" University

1. Strengths and Affirmations

2. Drafting of the program offered by the Department of Education and Professional Training at IAL UniBa, in coherence with the vision, mission and strategic development plan of the institution, as well as the support and use of a regulatory framework, which has ensured the implementation of the requirements of the law and of market requirements.
3. The general regulatory framework of UniBa is complete and there is a clear division of duties that each unit of the institution must perform. In order to implement the study program, there are cooperation agreements with actors inside and outside the country. At the end of each academic year, from the main unit and the basic unit, the progress of the implementation of cooperation agreements is analyzed in order to increase the quality of student training.
4. It turns out that the Department of Education and Professional Training, which is the unit responsible for the development of the Second Cycle Study Program "Professional Master" in Teacher "Language and Communication", has the experience, capacities, as well as the appropriate academic resources for providing of the study program.

Bulet

12

5. The Professional Master's study program in Teaching "Language and Communication" is a contemporary program. The institution has established the unit "BRIDGE" (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), which aims to encourage, enable and promote the importance of scientific research for Albania and the Region. This unit serves as an organization that closely cooperates with departments, institutes and non-profit organizations established by the institution and enable the pursuit and implementation of regional and national study and scientific policies.

6. During the development of the Second Cycle Study Program "Professional Master" in Teacher "Language and Communication", for the evaluation of students, clear criteria and diverse ways of testing and evaluating knowledge are used. Every document that contains the criteria of testing and assessment of knowledge is open and known to students. The Department of Education Sciences and Vocational Training encourages the use of diverse pedagogical methods, in accordance with the expected learning outcomes.

7. The Department of Social Sciences and Vocational Training, in the role of the unit responsible for the implementation of the study program, continuously adapts the content of the study program to the requirements of the labour market, being in constant consultation with other interested actors such as students, lecturers and other partners of society and the knowledge community.

8. The implementation of the Curriculum of the Second Cycle Study Program "Professional Master" in "Language and Communication Teacher", foresees the development of special skills in various fields of technological/pedagogical/linguistic/communicative nature. These skills are analyzed and reviewed at the end of various subjects and the study program.

9. Direction, administration and organization of the quality level by the Head of the Department and visible commitment of lecturers in teaching and scientific research in general

10. Didactic infrastructure in accordance with the quality standards of the realization of the study program of the Professional Master Teacher in "Language and Communication"

11. Modern infrastructure for teaching, necessary and adequate spaces for individual teaching and study, spacious and well organized, functional library at the service of staff and students to meet the expected results in the study program Professional Master Teacher in " Language and Communication" offered by this institution.

Weaknesses

1. The low number of students enrolled in this study program as a result of the decrease in the number of the population and the decrease in interest in following teaching programs.

(Standard V.4, Criterion 2)

2. Greater commitment is required in the recognition and publication in detail of the Professional Master Study program in Teacher "Language and Communication" not only through meetings in districts and schools, but also on the UniBa website. Greater advertising in different social media and cooperation with the users of these media for telling the values of this Study Program.

(Standard IV.4, Criterion 6)

3. Greater attention in the financing of scientific research for this Study Program, which can functions as a second master's program for increasing the quality of teaching and in the professional development of all teachers and leaders of 9-years and secondary schools.

(Standard II.7, Criterion 1)

Recommendation

1. UniBa to foresee the increase of the budget in the "Basic Fund for scientific research and scientific activities", "for basic scientific research", "for scientific activities" as well as "for supporting the publication of articles with an impact factor".
2. To work to increase the efforts to increase the mobility of students from this study program.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I.OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X